


PERFORMANCA E KUVENDIT TË KOSOVËS GJATË SESIONIT PRANVEROR

15 JANAR – 31 KORRIK 2024





Instituti Demokratik i Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

PËRMBAJTJE

06 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

08 Hyrje

09 1. ZHVILLIMET NË SEANCA

1.1 Ligjvënia

1.2 Mbikëqyrja ndaj Ekzekutivit

1.3 Rregullorja dhe normalizimi i precedentëve mosrespektues

1.4 Sjellja e Deputetëve dhe Mungesat

1.5 Përdorimi i gjuhës jo-parlamentare

23 2. ZHVILLIME TË VEÇANTA GJATË SESIONIT

2.1 Hartimi i Kodit të Sjelljes

2.2 Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve

2.3 Hartimi i Projektligjit të ri për Këshillin Prokurorial

25 3. PUNA E KOMISIONEVE PARLAMENTARE

35 4. TRANSPARENCA E KUVENDIT

39 PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME

43 REFERENCAT

COPYRIGHT © 2024. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Ueb: www.kdi-kosova.org


Layout and design: **envinion**

Shënim: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Të rinjtë dhe Shoqëria Civile për Integritet" [Eng: *Youth and Civil Society for Integrity*], i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe jo doemos reflekton qëndrimet e Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).





HYRJE



Ky raport analitik vlerëson punën e Kuvendit të Kosovës, nga fillimi i sesionit pranveror më 15 janar deri në përfundim të tij me datën 31 korrik 2024.

Raporti është rezultat i monitorimit sistematik nga ana e Institutit Demokratik të Kosovës, përmes pranisë fizike dhe ndjekjes në distancë të punimeve të Kuvendit, të seancave, komisioneve dhe aktiviteteve tjera të zhvilluara në Kuvend.

Pjesa e parë e raportit pasqyron zhvillimet në seanca të Kuvendit. Kjo pjesë e ndarë në pjesë të shkurtra trajton procesin ligjvënës, mbikëqyrjen ndaj ekzekutivit, çështjen e zbatimit të Rregullores dhe transparencën e Kuvendit ndaj publikut. Ndryshe nga herët e kaluara, Raporti, përfshin edhe një rubrikë të përbërë nga ngjarje të veçanta gjatë sesionit.

Në pjesën e dytë të raportit është e paraqitur puna e komisioneve, përmes ofrimit të të dhënave kuantitative dhe kualitative. Së bashku me paraqitjen e numrave të aktivitetit të këtyre komisioneve, brenda përshkrimeve ofrohen edhe vlerësime për segmentet apo hapësirat ku komisionet performuan mirë, si dhe kritika për mangësitë ku ato duhet të synojnë të për mirësohen.

Për fund, Raporti, në formë përmbledhëse përfundon me rekomandime për Kuvendin dhe deputetët, në atë formë që mangësitë e shpërfaqura gjatë këtij sesioni, fillimisht të evidentohen, mandej të veprohet në drejtim të adresimit dhe evitimit të tyre.



ZHVILLIMET NË SEANCA























1.1 Ligjvënia

Funksioni legjislativ i Kuvendit të Kosovës paraqet funksionin qendror të tij. Në veprimtarinë ligjvënëse gjatë këtij sesioni, prania e mangësive të zakonshme është e dukshme, kurse dallimi [ndërmjet sesioneve] shfaqet vetëm tek rënia në intensitetin e punës. **Gjatë sesionit në fjalë, Kuvendi, nuk ka mbajtur mbledhje për 13 javë pune.** Zakonshëm, Kuvendi, ka organizuar punën në agjenda të ngarkuara, të vendosura në periudha të shkurtra, trajtimi cilësor i të cilave është vështirë të jetë i mundur. Ndërsa, roli i deputetëve në hartimin e materialit legjislativ lë hapësirë të madhe për përmirësim. **Përgjithshëm, rubrika e punës legjislative është karakterizuar nga mungesa e planifikimit të ekuilibruar: punë jo e sistemuar, rendet e ditës të ngarkuara, të shpërndara në pak seanca dhe mungesa e një roli të drejtpërdrejtë të deputetëve në ligjberje.**

Në ekzaminimin e përgjithshëm, ndërmjet sesioneve, mund të pohohet se në kuptim të punës legjislative nuk ka ndonjë zhvillim që përfaqëson ndryshim përmbajtësor. Trendi i rënies në kuptim të numrave ka vazhduar, ashtu sikurse parashihej. Kjo sepse që nga fillimi i kësaj legjislature vazhdimisht ka pasur rënie në performancën e Kuvendit. Arsyeja kryesore ka qenë sfida e shumicës parlamentare për të siguruar kuorumin e nevojshëm për votim të projektligjeve. **Gjatë sesionit pranveror të këtij viti, Kuvendi ka mbajtur 29 seanca, 10 prej të cilave ishin seanca plenare, 7 vazhdime të seancave, 6 të jashtëzakonshme dhe 6 seanca solemne.**¹ Ndërsa, në sesionin pranveror të vitit të kaluar Kuvendi kishte mbajtur 49 seanca, 22 nga të cilat ishin plenare, 17 vazhdime, 8 të jashtëzakonshme dhe 2 solemne.² Mungesën e planifikimit të përpiktë të agjendës legjislative e vërejmë qartazi edhe këtë vit. Raporti i numrave, ndërmjet seancave plenare dhe seancave të vazhduara shpërfaqë këtë situatë, ku shpeshherë ka pasur nevojë për seanca vazhduese – për të përmbyllur rendin e ditës së seancës paraprake.

TABELA 1.1 – Numri i Seancave

Sesioni pranveror 2024	Sesioni pranveror 2023
 10  Plenare	 22  Plenare
 7  Vazhdime	 17  Vazhdime
 6  Solemne	 2  Solemne
 6  Të Jashtëzakonshme	 8  Të Jashtëzakonshme
 29  GJITHSEJ	 49  GJITHSEJ



Në një formë të rëndomtë në praktikën parlamentare të Kosovës, votimi i materialit legjislativ, edhe këtë sesion është zgjatur disa javë apo muaj nga momenti i elaborimit në seancë parlamentare. Normalizimi i kësaj praktike paraqet problem serioz për cilësinë e shqyrtimit parlamentar. Votimi, duhet të paraprihet nga debat i plotë dhe shterues, i cili dërgon drejt shqyrtimit përfundimtar nga ana e deputetëve – ai nuk duhet të reduktohet në një organizim për arritje të numrave të domosdoshëm, derisa deputetët shndërrohen në vegla votimi. Një praktikë si kjo, megjithëqë është kritikuar mjaft arsyeshëm, Kuvendi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të përmirësimit. **Kuvendi, përgjatë 3 muajve të parë, ka miratuar 2 projektligje, kurse në periudhën pasuese miratoi 34 të tjerë.**³ – 20 nga të cilët në vetëm dy seanca.⁴ Në rrethana optimale të pranisë së vazhdueshme të kuorunit të nevojshëm, Kuvendi, shqyrtimin përfundimtar të materialit legjislativ do të duhej ta zhvillonte në seancën diskutuese.

Për një praktikë parlamentare të planifikuar, Kuvendi, duhet të rrisë numrin e seancave, kurse rendet e ditës duhet të jenë më të arritshme në kuptim të volumit që përmbajnë. Kësisoj, seancat do të duhej të përshtateshin më mirë në kalendarin e ditëve të punës, gjersa nuk do të duhej të kufizoheshin në ditë të caktuara të javës. Rregullorja si ditë pune për mbledhje të Kuvendit, përcakton të gjitha ditët e javës, përjashtimisht fundjavave dhe festave zyrtare.⁵

Megjithëqë gjatë sesionit ka pasur disa raste kur projektligjet janë iniciuar nga deputetët, në pamje të plotë, roli i deputetëve në procesin e ligjvënies, vazhdon të mbetet jo i kënaqshëm. Deputetët, edhe më tutje penalizohen nga mungesa e burimeve dhe njohurive të nevojshme që në procesin e ligjberjes, të jenë përcaktues të përmbajtjes së materialit legjislativ. Prandaj, mund të përfundohet se Kuvendi ka vazhduar të shërbejë si organ për trajtimin e materialit të ardhur nga ekzekutivi, rol ky që duhet të avancohet, me synimin për aktivizim më të madh të deputetëve në hartimin e projektligjeve. Rënia e punës në organin legjislativ përfaqëson ndryshimin ndërmjet sesioneve. Së bashku me rënien drastike të numrit të mbledhjeve, Kuvendi, ka shfaqur ulje të aktivitetit edhe në realizimin e agjendës legjislative. **Përgjatë sesionit janë miratuar gjithsej 36 projektligje (35 projektligje dhe një Projekt-Kod), numër ky më i ulët se sa në sesionin e njëjtë të vitit të kaluar, kur ishin miratuar 44 projektligje.** Shprehur në përqindje, agjenda e Kuvendit është përbushur 28%, por e cila përfshin projektligje të grumbulluara ndër vite. Vetëm 3 projektligje të miratuara gjatë këtij sesioni janë pjesë e agjendës legjislative të ekzekutivit të vitit 2024. **Që do të thotë se, më pak se 1% e agjendës legjislative 2024 të Qeverisë, është miratuar gjatë këtij sesioni.** Nga projektligjet e miratuara këtë sesion, 20 janë marrëveshje ndërkombëtare, derisa janë vetëm 15 projektligje dhe 1

projekt kod që përmbajtësisht rregullojnë subjekte apo tema të ndryshme. **Në procedurë shqyrtuese të Kuvendit kanë mbetur 45 projektligje, nga të cilat 9 janë të agjendës legjislative të Qeverisë të vitit 2024.** Përmbledhja e këtyre të dhënave, vë në pah faktin se 99% e agjendës legjislative të Qeverisë të vitit 2024 mbetet për trajtim gjatë sesionit vjeshtor.

Përgjithshëm, rezultati zhgënjyes i punës gjatë sesionit, paraqet një zhvillim të parashikueshëm, duke vlerësuar trendin e rënies në punë që kjo legjislaturë kishte treguar në sesionet paraprake. Faktori kryesor është mungesa e një stabiliteti në shumicën parlamentare, problemet brenda të cilës janë shfaqur përherë gjatë sesionit. Ndonëse me një shumicë të deklaruar formalisht, partia në pushtet vuajti mungesën e kuorunit, kurse një marrëveshje e përkohshme ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës, bëri të mundur votimin e 20 marrëveshjeve ndërkombëtare. Marrëveshjet ndërkombëtare, paraprakisht ishin mbështetur edhe nga partitë tjera opozitare, porse votimi i tyre dështonte në mungesë të numrave.

Përgjatë sesionit janë miratuar gjithsej 36 projektligje (35 projektligje dhe një Projekt-Kod), numër ky më i ulët se sa në sesionin e njëjtë të vitit të kaluar, kur ishin miratuar

44 projektligje.

Shprehur në përqindje, agjenda e Kuvendit është përbushur 28%, por e cila përfshin projektligje të grumbulluara ndër vite. Vetëm 3 projektligje të miratuara gjatë këtij sesioni janë pjesë e agjendës legjislative të ekzekutivit të vitit 2024. Që do të thotë se, më pak se 1% e agjendës legjislative 2024 të Qeverisë, është miratuar gjatë këtij sesioni.





1.2 Mbikëqyrja ndaj Ekzekutivit

Në kuadër të punës së Kuvendit, mbikëqyrja – së bashku me ligjvënien – paraqesin funksionet qendrore.⁶ Megjithëqë veprimtaria mbikëqyrëse paraqet instrument thelbësor në punën parlamentare, Kuvendi, edhe gjatë këtij sesioni, nuk ka ndërmarrë masa për fuqizimin e mbikëqyrjes. Për më tepër të dhënat e përditshme shpërfaqin një rënie të aktivitetit mbikëqyrës – si në pikëpamje cilësore ashtu edhe në atë sasiore.

Përgjatë gjithë sesionit, përkundër zhvillimeve më rëndësi të jashtëzakonshme, Kuvendi, nuk e ka ftuar asnjëherë kreun e ekzekutivit në një seancë raportimi apo interpelancë.

Një opozitë, sikurse kjo, megjithëse nuk ka numra të mjaftueshëm që vetiu të iniciojë procese më substanciale të llogaridhënies, do të duhej që së paku të shfrytëzonte mjetet elementare të llogaridhënies – dhe raportimet apo interpelancat të ishin ngjarje të shpeshta në praktikën parlamentare të Kosovës. Ngjashëm, deputetët e bllokut shumicë, kundrejt përfaqësuesve të ekzekutivit, do të duhej të silleshin në përputhshmëri me mandatin si deputet të Kuvendit të Kosovës,⁷ si autoritet mbikëqyrës ndaj Qeverisë. Në praktikën ekzistuese, sikurse në seanca edhe në komisione, deputetët e shumicës parlamentare janë shfaqur si figura aprovimi të veprimeve të Qeverisë. Qasja e deputetëve të dëgjueshëm e ka liruuar ekzekutivin nga përgjegjësia kundrejt Kuvendit, fenomen ky shqetësues për Kosovën.

Gjatë sesionit pranveror, Kuvendi, është përballur me një zhvlerësim të mekanizmave kryesorë të mbikëqyrjes, sikurse hetimi nëpërmjet një komisioni parlamentar apo pyetjeve parlamentare. Nga ky këndvështrim, duhet të evidentohet pengimi i punës së Komisionit Hetimor për Rezervat Shtetërore, i themeluar gjatë sesionit të kaluar.⁸ Fillimisht, trupi hetues për rezerva është penguar në mbajtjen e mbledhjes themeltare, për shkakun e bojkotit të plotë nga ana e deputetëve të pushtetit.⁹ Kurse, gjendje e mëtejshme ishte shndërruar në një bojkot të pjesshëm pas themelimit të këtij Komisioni. Deputetët pa dallim, qoftë nga pushteti apo opozita, nuk kufizonin aktivitetin e tyre në përputhje me mandatin hetues të dhënë nga Kuvendi, ndërsa mbledhjet përfundimisht shërbenin më shumë si mundësi shprehjeje të opinioneve politike për çështje krejt të jashtme, në raport me temën për hetim. **Kësisoj, Komisioni hetimor për Rezervat Shtetërore, përfundoi mandatin e plotë akoma pa filluar hetimin – pa trajtuar asnjë dëshmi dhe pa zhvilluar asnjë seancë intervistimi me dëshmitarët.**¹⁰

Në mënyrë që të ushtronte funksionin mbikëqyrës kundrejt ekzekutivit, Kuvendi themeloi edhe dy komisione tjera: Komisionin Hetimor për Menaxhimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Diplomatik¹¹ dhe Komisionin Hetimor për Procesin e Subvencionimit të Blerjes së Teksteve Shkollore.¹² Puna e këtyre dy trupave, duke vlerësuar se janë në mes të intervistimit të dëshmitarëve, nuk mund të paragjykohej, porse duke vlerësuar intensitetin e punimeve mund të përfundohet se komisionet kanë shpenzuar kohë të tepërt në hartimin e Planit hetues, derisa krejtësisht në fund të sesionit filluan veprimin hetues në praktikë. Në të dy komisionet, bashkëpunimi i deputetëve në kuadër të hetimit është i vështirë, në rrethana të ekzistimit të një çarje ndërmjet partisë në pushtet dhe opozitës. Në Komisionin për Tekste Shkollore, deputeti Shemsedin Dreshaj, në cilësinë e deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për mbajtjen e mbledhjes së para planifikuar, shpalli punimet e komisionit për sesion të mbyllura para kohës.¹³ Një situatë e ngjashme ndodhi edhe në Komisionin për Shërbimin Diplomatik, ku anëtarët nuk janë pajtuar se si të procedojnë me listën e të ftuarve për intervistim në sesionin tjetër, derisa mbledhja e fundit mbaroi në klimën tanimë të zakonshme antagoniste.

Në anën tjetër, dy komisione për hetim, janë në pritje të prezantimit të kornizës hetuese në seancën plenare.¹⁴ Në të dy rastet, deputetët e opozitës, me nënshkrimet e tyre kanë bërë të domosdoshëm [ligjërish] themelimin e këtyre trupave,¹⁵ mirëpo prezantimin e arsyeve për themelimin e këtyre trupave, nuk e kanë bërë në seancë të Kuvendit. Në çfarëdo kushtesh, mosgatishmëria për të prezantuar arsyet dhe platformën hetuese, paraqet një veprim jo të denjë për opozitën, që zhvlerëson edhe hetimin për çështjet në fjalë. Po ashtu meqë në sesionin vjeshtor kjo Legjislaturë hyn në 6 mujin e fundit të saj, sipas Ligjit për Hetim Parlamentar ato më nuk mund të themelohen.

Rënie në vlerësim ka përjetuar edhe mekanizmi i pyetjes parlamentare, si mënyrë mbikëqyrjeje të ekzekutivit. **Gjatë sesionit pranveror të këtij viti deputetët kanë parashtruar gjithsej 110 pyetje ndaj ekzekutivit, numër ky më i ulët se në sesionin pranveror të vitit 2023 gjatë së cilit deputetët kishin parashtruar gjithsej 168 pyetje parlamentare.**




110 pyetje parlamentare gjatë këtij sesioni, deputetët i kanë parashtruar ndaj ekzekutivit 219 herë. Kjo rritje, në të vërtetë, është ndikuar nga mungesa e përgjigjeve të ekzekutivit, meqë një masë e këtyre pyetjeve, janë përsëritur vazhdueshëm, duke rritur numrin përfundimtar të tyre.

Në kuptim të shtrirjes së pyetjeve parlamentare të parashtruara, duhet të pohohet se raporti nuk reflekton statistika të ngjashme me ato të vitit të kaluar. Deputetët nga të dy blloqet, kanë treguar trende të ndryshme: derisa deputetët e partisë në pushtet, Vetëvendosjes, kanë

shënuar rënie, nga 1.8 pyetje për deputet në 1.2; deputetët e partive opozitare kanë treguar përmirësime. Kësisoj, deputetët e AAK-së kanë trefishuar numrin e parashtrimit të pyetjeve parlamentare nga 1.6 në 5.3 pyetje për deputet, kurse trende rritëse vërehen edhe tek PDK, me rritje nga 2.8 pyetje për deputet, në 5 sosh. Kjo parti prinë me numrin e pyetjeve të parashtruara. Në rastin e LDK-së, vërehet një rritje – me mesatarisht, afërsisht 1 pyetje për deputet. Krejt në fund, shqetësues mbetet mungesa e pyetjeve nga ana e deputetëve të komuniteteve jo shumicë në Kuvendin e Kosovës.

TABELA 1.2 – Pyetjet Parlamentare sipas Grupeve Parlamentare¹⁶





Sesioni pranveror 2024



Sesioni pranveror 2023



Gatishmëria e përfaqësuesve të ekzekutivit për të iu përgjigjur pyetjeve parlamentare të deputetëve, ka lënë shumë për të dëshiruar. Ministrat rregullisht kanë shmangur seancat, rendi i ditës i të cilave përmban pyetje parlamentare, veprim ky në kundërshtim me funksionimin e përcaktuar sipas Kushtetutës së Kosovës dhe Rregullores së Kuvendit. Në vetëm 33 raste (15% e të pyetjeve parlamentare), institucioni i pyetjes parlamentare është përdorur suksesshëm, me përgjigje nga anëtarët e ekzekutivit- tregues ky për një zhvlerësim të kësaj forme të mbikëqyrjes.

brenda kabinetit mbetet drejtuesi i Ministrisë së Bujqësisë, Faton Peci i cili ka treguar gatishmëri më të lartë për të iu përgjigjur deputetëve. Të dhënat tregojnë se nga 9 pyetje që i janë parashtruar, ai ka dhënë vetëm 1 përgjigje, mirëpo kjo për faktin meqë vetë deputetët parashtrues të pyetjeve mungonin.

Në këtë performancë të pakënaqshme, rol të madh ka luajtur edhe qasja e papërgjegjshme e deputetëve, meqë në mbi 80 raste, ata munguan në seancën kur pyetja që ata parashtruan zyrtarisht do të lexohej. Në paraqitjen tabelare të mëposhtme, mund të gjeni raportin e pyetjeve të parashtruara duke përfshirë edhe përsëritjet e pyetjeve dhe përgjigjeve të ofruara nga anëtarët e ekzekutivit.

Në këtë zhvillim, fillimisht, përgjegjësia duhet t'i bartet Qeverisë. Disa nga përfaqësuesit e saj kanë shfaqur sjellje të papërgjegjshme kundrejt institucionit të Kuvendit. Ekzekutivi, duke filluar nga udhëheqësi i tij dhe bartësit e pozicioneve të ministrave, në shumicën e rasteve kanë demonstruar mungesë të theksuar të llogaridhënies. **Kryeministri Kurti, në pyetjet që i janë parashtruar 36 herë, nuk ka ofruar asnjë përgjigje, derisa shumica e kabinetit kanë treguar shpërfillje të plotë për pyetjet parlamentare. Në këtë qasje, shquhet Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, i cili është 'kampion i papërgjegjshmërisë'¹⁷, meqë për afërsisht 2 vite bojkoton plotësisht pyetjet parlamentare. Kurse, një rast i kundërt**




TABELA 1.2 - Pyetjet e parashtruara ndaj Ekzekutivit dhe përgjigjet

Sesioni pranveror 2024



Sesioni pranveror 2023





Sesioni pranveror 2024

Artana Rizvanolli
 8 Pyetje 3 Përgjigje

Hekuran Murati
 24 Pyetje 2 Përgjigje

Xhelal Sveçla
 16 Pyetje 0 Përgjigje

Arbërie Nagavci
 9 Pyetje 0 Përgjigje

Rozeta Hajdari
 8 Pyetje 0 Përgjigje

Donika Gërvalla
 3 Pyetje 1 Përgjigje

Hajrullah Çeku
 14 Pyetje 4 Përgjigje

Armend Mehaj/Ejup Maqedonci
 0 Pyetje 0 Përgjigje

GJITHSEJ
 219 Pyetje 33 Përgjigje

Sesioni pranveror 2023

Artana Rizvanolli
 10 Pyetje 10 Përgjigje

Hekuran Murati
 8 Pyetje 6 Përgjigje

Xhelal Sveçla
 13 Pyetje 0 Përgjigje

Arbërie Nagavci
 19 Pyetje 14 Përgjigje

Rozeta Hajdari
 10 Pyetje 8 Përgjigje

Donika Gërvalla
 10 Pyetje 2 Përgjigje

Hajrullah Çeku
 17 Pyetje 12 Përgjigje

Armend Mehaj/Ejup Maqedonci
 2 Pyetje 1 Përgjigje

GJITHSEJ
 171 Pyetje 57 Përgjigje




1.3 Rregullorja dhe normalizimi i precedentëve mosrespektues

Miratimi i Rregullores së re, në vitin 2022,¹⁸ ishte konsideruar si hap i rëndësishëm në përmirësimin e punës parlamentare. Fatkeqësisht, dallimi ndërmjet periudhave nuk është i vërejtshëm, meqenëqë moszbatueshmëria e Rregullores në shumë konteste është përsëritur vazhdueshëm, deri në masën që është krijuar njëfarë praktike e shkeljes së saj. **Duhet të theksohet se në veprimtaritë shkelëse të Rregullores gjatë këtij sesioni, rolin kryesor ka vazhduar ta luaj Kryetari i Kuvendi, si autoriteti për interpretimin e saj.**¹⁹

Siç u cek më lartë, bojkotimi i pyetjeve parlamentare nga ana e ekzekutivit, ka vazhduar edhe gjatë këtij sesioni. **Neutraliteti i Kryetarit të Kuvendit, përballë bojkotimit të pyetjeve parlamentare paraqet një prej shembujve, kur ai ka shmangur në një formë flagrante Rregulloren, duke e cilësuar si të pranueshëm veprimin e Qeverisë.** Në kuadër të kapitullit të kontrollit parlamentar, Rregullorja i delegon kryesuesit kompetencën e tërheqjes së vërejtjes²⁰ karshi përfaqësuesve të ekzekutivit të cilët sillen në mënyrë të papërgjegjshme ndaj obligimit për të ofruar përgjigje në pyetjet e deputetëve. Kjo shpërfillje e Kuvendit dhe deputetëve përfaqëson shkelje të rëndë të rregullimit ekzistues dhe udhëheqësi i këtij institucioni, do të duhej të mbante një qëndrim kritik, me qëllim të mos shndërrimit të bojkotit të pyetjeve parlamentare, si mjet i përdorshëm politik.

Një nga shkeljet recidiviste gjatë këtij sesioni është djegia e pyetjes së deputetit/es, me arsyetimin e mungesës. Gjatë vitit të kaluar kemi një rast të tillë të tejkalimit të kompetencave, që Rregullorja i delegon për Kryetarin apo kryesuesin e seancës. Gjatë hapësirës së pyetjes parlamentare, në seancën e 20 prillit të vitit 2023, Kryetari Konjufca, me arsyetimin e mungesës se deputetes Blerta Deliu-Kodra, përfundoi se mundësia e bartjes së pyetjes, nuk do të aplikohet në këtë rast, meqë mungesa e deputetes e "djegë pyetjen parlamentare."²¹ Ngjashëm këtë vit, në seancën e 8 shkurtit, deputeti Avdullah Hoti është shtyrë në tërheqje të pyetjes, pas insistimit të kryesueses.²² Një veprim si ky, nuk përlligjet në asnjë nga materialet që rregullon raportet ndërmjet zyrtarëve në Kuvend dhe kjo paraqet një praktikë krejtësisht jo parlamentare.

Duhet të theksohet se në veprimtaritë shkelëse të Rregullores gjatë këtij sesioni, rolin kryesor ka vazhduar ta luaj Kryetari i Kuvendi **si autoriteti për interpretimin e saj.**





Një nga shkeljet më të shquara, që përfaqëson një praktikë të themeluar në Kuvendin e Kosovës është mënyra se si interpretohet kohëzgjatja e mandatit të Komisioneve Hetimore. Në praktikën ekzistuese, Komisioneve Hetimore, mandati i dhënë nga Ligji për Hetim Parlamentar, prej 6 muajsh,²³ iu zgjatet për periudhën e kaluar në pushimin ndërmjet sesioneve. Një sqarim i ofruar nga Zyra Ligjore e Kuvendit, shpjegohet se ky interpretim mbështetet në përcaktimin i Rregullores së, më saktësisht mos llogaritjen e afateve të pushimit ndërmjet sesioneve.²⁴ Kjo mënyrë e interpretimit paraqet një veprim në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, meqenëqë përcaktimi në fjalë ka subjekt afatet procedurale në punën parlamentare, ai kurrësi nuk mund të kufizojë apo zgjatë mandatin e dhënë në formë të saktë, përmes një ligji tjetër. Së dyti, Rregullorja e Kuvendit, përcaktues për të gjitha procedurat e hetimeve parlamentare ka Ligjin për Hetim Parlamentar.²⁵ Ndërsa Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk përlligjë praktikën parlamentare të mos llogaritjes së periudhës ndërmjet sesioneve si kohë e shpenzuar e mandatit.

nga zyrtarët e sigurisë.²⁶ Pas tentimit për të siguruar mbarëvajtjen e mbledhjes, duke shprehur edhe vërejtje kundrejt deputetëve Zyba dhe Ferati, kryesuesja Bogujevci, në përputhje me kompetencat që i burojnë nga Rregullorja,²⁷ vendosi për përdorimin e masës së largimit nga seanca të dy deputetëve në fjalë. Një situatë si kjo, paraqet një nga rastet, rrallëherë të hasura, kur personeli i sigurisë nuk i bindet urdhrin të një kryesuesi/e për të aplikuar masën e shqiptuar nga ai/ajo. Padyshim që edhe kjo ngjarje paraqet një shkelje të rëndë të përgjegjësisve të ndara sipas Rregullores dhe Kuvendi duke trajtuar seriozisht këtë lëshim, duhet të ndërmerre hapa në mënyrë që ai të mbetet si rast i izoluar dhe përsëritja të ishte e pamundur. Në këtë drejtim, Kuvendi, ashtu sikurse nuk ka shpjeguar kontekstin, nuk ka njoftuar për ndonjë masë të aplikuar për zyrtarët mos zbatues.

Botëkuptimi që vendimmarrjen brenda Kuvendit e kufizon tek vullnetet individuale, ka bërë që praktikat kundër Rregullores të vazhdojnë zgjerimin, duke u normalizuar në tërësi.

Në pikëpamje të mosrespektimit të institucionit të Kuvendit dhe frymës së Rregullores, ishte edhe mënyra e trajtimit të Marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës, për shfrytëzimin e objekteve të burgut në Gjilan. Ndonëse e nënshkruar në 2022, për shkakun e përmbajtjes kontroverse, nuk votohej në Kuvendin e Kosovës – kryesisht për arsyet, e artikuluara të disa deputetëve, që shprehnin shqetësimin për përmbajtjen e Marrëveshjes. Përfundimisht, Kuvendi, në seancën e 16 majit, me 75 vota për dhe 13 kundër, duke shprehur vullnetin mospajtues kundrejt përmbajtjes, refuzoi këtë Marrëveshje.²⁸ Përmes një njoftimi, Ministria e Drejtësisë, deklaroi se ka filluar ri-negocimin e përmbajtjes së Marrëveshjes, kurse shpejtazi, duke e përfunduar këtë rishikim të përmbajtjes në formë jotransparente, Marrëveshja u rikthye në Kuvend, përmbajtësisht në formatin e njëjtë një javë më vonë. Ky proces është përmbyllur, me votim në seancën e 23 majit,²⁹ me tekstin e marrëveshjes, që pretendohej të ketë ndryshuar, ndërsa në dilemat integrale, rreth të cilave deputetët kishin ngritur shqetësimet e tyre, marrëveshja kishte mbetur e paprekur. Kësisoj, Qeveria, ka shpërfillur plotësisht vullnetin e Kuvendit për Marrëveshjen në fjalë, të manifestuar në votimin e 17 majit; derisa ka rikthyer tekstin [në mënyrë jotransparente] përmbajtësisht identik, për të votuar në Kuvendin e Kosovës.

Ndryshe nga rastet e përshkruar më lartë, në një rast tjetër përpjekja e nënkryetares Saranda Bogujevci për të vendosur në rend mbarëvajtjen e seancës, përmes largimit të deputetëve Salih Zyba dhe Ferat Shala, është refuzuar



1.4 Sjellja e Deputetëve dhe Mungesat

Në analizë të tërësishme, përmes të dhënave mbi mungesën e deputetëve mund të derivohet përfundimi se ky problem përveç se nuk ka treguar shenja përmirësimi, trendi i rritjes së mungesave është i vërejtshëm. **Në 17 mbledhje për të cilat, Kuvendi ka mbajtur evidenca, deputetët kanë munguar plotë 525 herë, apo mesatarisht për çdo seancë 24,3% e deputetëve kanë munguar. Në proporcion me numrin e deputetëve, shtrirja e mungesave tek partitë është e shfaqur tabelën e mëposhtme. Deputetët e Partisë Demokratike kanë numrin më të lartë të mungesave gjatë këtij sesioni. Ata kanë munguar në 26,5% të seancave; pasuar nga Lidhja Demokratike, deputetët e së cilës munguan në 22% të rasteve; deputetët e Vetëvendosjes munguan në 13,9% të rasteve, kurse deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, munguan në 9% të rasteve. Ky volum i mungesave përbëhet edhe nga mungesat e Listës Serbe, të cilët kanë munguar në 87,5% të seancave pasi pothuajse gjatë gjithë legjislaturës kanë bojkotuar Kuvendin; ndërsa deputetët e tjerë të pakicave, munguan në rreth 15% të seancave.**

Rregullorja, përcakton mundësinë e rikthimit të një marrëveshje në rast të votimit kundër të shprehur nga ana e deputeteve.³⁰ Mirëpo qartazi, procesi do duhej të kthehej në pikën fillestare nëpërmjet një rinegociimi të marrëveshjes në një mënyrë transparente dhe të atillë që prek çështjet kundërtënëse, mbi të cilat ligjvënësit kanë shprehur dyshimet e tyre. Procesi i rinegociimit nuk trajtoi kundërshtimet e deputetëve dhe për këtë autoritetet e Kuvendit, nuk vepruan aktivisht, që të pamundësojnë këtë shkelje të rolit të institucionit të Kuvendit.

Në 17 mbledhje për të cilat, Kuvendi ka mbajtur evidenca, deputetët kanë munguar plotë 525 herë,

apo mesatarisht për çdo seancë 24,3% të deputetëve kanë munguar.




TABELA 1.4 - Mungesat e Deputetëve gjatë Sesionit Pranveror 2024³¹











LVV	56 Numri i deputetëve	1008 Pjesëmarrja e paraparë	140 Mungesat	13,9% Përqindja
PDK	18 Numri i deputetëve	324 Pjesëmarrja e paraparë	86 Mungesat	26,5% Përqindja
LDK	16 Numri i deputetëve	288 Pjesëmarrja e paraparë	64 Mungesat	22% Përqindja
AAK	8 Numri i deputetëve	144 Pjesëmarrja e paraparë	13 Mungesat	9% Përqindja
MULTIETNIK	8 Numri i deputetëve	144 Pjesëmarrja e paraparë	22 Mungesat	15% Përqindja
LISTA SERBE	12 Numri i deputetëve	216 Pjesëmarrja e paraparë	189 Mungesat	87,5% Përqindja
DEPUTETËT E PAVARUR	2 Numri i deputetëve	36 Pjesëmarrja e paraparë	11 Mungesat	30,6% Përqindja
GJITHSEJ	120 Numri i deputetëve	2160 Pjesëmarrja e paraparë	525 Mungesat	24,3% Përqindja

TABELA 1.5 - Mungesat e Deputetëve gjatë Sesionit Pranveror 2023

LVV	57 Numri i deputetëve	2052 Pjesëmarrja e paraparë	188 Mungesat	9% Përqindja
PDK	18 Numri i deputetëve	648 Pjesëmarrja e paraparë	129 Mungesat	19% Përqindja
LDK	16 Numri i deputetëve	576 Pjesëmarrja e paraparë	122 Mungesat	21% Përqindja
AAK	8 Numri i deputetëve	288 Pjesëmarrja e paraparë	52 Mungesat	18% Përqindja
MULTIETNIK	8 Numri i deputetëve	288 Pjesëmarrja e paraparë	41 Mungesat	14% Përqindja
LISTA SERBE	12 Numri i deputetëve	432 Pjesëmarrja e paraparë	431 Mungesat	99,7% Përqindja
DEPUTETËT E PAVARUR	1 Numri i deputetëve	36 Pjesëmarrja e paraparë	9 Mungesat	25% Përqindja
GJITHSEJ	120 Numri i deputetëve	4320 Pjesëmarrja e paraparë	972 Mungesat	22,5% Përqindja



TABELA 1.6 – Deputetët me numrin më të madh të mungesave gjatë Sesionit Pranveror 2024

 BEXHET PACOLLI	 FITIM UKA	 GANIMETE MUSLIU
 14 Numri i Mungesave	 13 Numri i Mungesave	 13 Numri i Mungesave <small>(Ka munguar për shkak të problemeve shëndetësore)</small>
 ARDIAN KASTRATI	 XHAVIT HALITI	
 12 Numri i Mungesave	 10 Numri i Mungesave	

Në pikëpamje krahasimtare, deputetët e Kuvendit të Kosovës, në sesionin pranveror të vitit të kaluar kishin treguar numra përafërsisht të ngjashëm të mungesave. Asokohe, të dhënat ilustronjë mungesat në nivel pak më të ulët, ndonëse shifër e parëndësishme në aspekt krahasimor. Sipas bilancit të 36 mbledhjeve, evidencat e të cilave ishin regjistruar, deputetët munguan në 972 raste, apo shprehur në numra 22,5% e deputetëve mungonin në çdo seancë. Luhatjet e partive politike, përfaqësojnë pjesën më interesante të analizës krahasimtare – PDK ka treguar ngritje në mungesave nga 19% në 25%, sikurse Vetëvendosje, nga 9% në 15%; ndërsa AAK, ka treguar shenja të dukshme përmbyseje të të dhënave negative të vitit të kaluar, nga 18% sa mungonin në 9%. Partitë apo grupimet e tjera politike, nuk kanë treguar lëvizje ndryshuese – LDK, Grupi Multietnik, Lista Serbe vazhdojnë të mungojnë në nivele të përafërta me të dhënat e vitit të kaluar. Me përjashtim të deputetëve të Listës Serbe, të cilët munguan në 15 seanca, nga radhët e grupeve tjera parlamentare, shpërndarja e mungesave individuale, pasqyrohet në një raport më të ekuilibruar. Behgjet Pacolli, Fitim Uka dhe Ganimete Musliu³² janë tre deputetët me numrin më të madh të mungesave të realizuara gjatë sesionit pranveror të vitit 2024 – të tre këta me nga 13 mungesa, ilustronjë këtë raport të barabartë.

1.5 Përdorimi i gjuhës jo-parlamentare

Ndonëse, nuk ka pasur raste të shquara të gjuhës jo parlamentare sikurse në vitin paraprak, nuk mund të thuhet se deputetët kanë treguar shenja progresi në këtë çështje. Për dallim nga prania e përhershme e kësaj sjellje gjatë vitit të kaluar, gjuha jo parlamentare dhe fjalori i papërshtatshëm ishin pjesë e punimeve gjatë këtij sesioni, më tepër në një ritëm sporadik dhe të kufizuar në disa raste.

Një nga arsytet e mungesës së incidenteve të tilla, ka qenë fakti se gjatë këtij sesioni aktiviteti i përgjithshëm i Kuvendit ka rënë dukshëm. **Ndërsa, qartazi, një pjesë të përballjeve që prodhon të tilla skena fyerjeje dhe ofendimesh, janë bartur në komisione, punimet e të cilave ishin të mbushura me shprehje dhe fjalor të papërshtatshëm.** Veçanërisht, ndër të dalluarat ishin mbledhjet e komisioneve hetimore – fjalori dhe përmbajtja e punës së të cilave ka shfaqur mangësi serioze, nga këndvështrimi i plotësimit të një standardi etik të mbarë pranueshëm.³³

Në anën tjetër, Kodi i Sjelljes së Deputetëve, si dokument që rregullon sjelljen dhe përcakton masat ndëshkimore kundrejt deputetëve është ende duke pritur miratimin nga ana e Kuvendit. Pa hamendje, gjendja në Kuvend paraqet rastin ideal për vënie në ushtrim një dokument të këtij lloji. Porse, ekziston rreziku i të kuptuarit të Kodit, si një kusht formal, pa ndryshuar qasjen interpretuese të masave ndëshkimore. Rrjedhimisht, ekzistenca e tij, mund të krijojë iluzionin e vendosjes së rregullit, kurth ky që nuk do të përmirësonte përmbajtësisht punën parlamentare. Për institucionin ligjvënës, së bashku me Kodin e Sjelljes që përmban modalitete ndëshkimi [domosdoshëm] nevojitet një lexim tërësisht i ndryshëm – një transformim në të kuptuarit dhe interpretimit të masave ndëshkimore.



ZHVILLIME TË VEÇANTA GJATË SESIONIT





Megjithëse, sesioni pranveror gjatë vitit 2024 ishte mjaft joaktiv, ai ka prodhuar disa zhvillime apo ngjarje të cilat duhet të veçohen për nga rëndësia. Përfundimi i draftimit të Kodit të Sjelljes në Komisionin për Legjislacion paraqet një nga ngjarjet që duhet të theksohet prej angazhimeve të deputetëve.³⁴ Ndërsa, edhe këtë sesion ka ndodhur votimi i projektligjeve, të cilave menjëherëshëm iu është kontestuar përmbajtja. Ndër projektligjet që kanë prodhuar më së shumti debat gjatë sesionit kanë qenë, Projektligji për Këshillin e Pavarur të Medieve dhe Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

2.1 Hartimi i Kodit të Sjelljes

Hartimi i Kodit të Sjelljes kishte filluar gjatë sesionit vjeshtor të vitit të kaluar, ndërsa ishte shoqëruar me një debat të gjerë mbi përmbajtjen, ku vend kishin zënë pretendimet e kundërta ndërmjet deputetëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Si pjesëmarrëse në grupin punues, KDI, kishte kritikuar në tërësi versionin fillestar të tekstit, duke vënë në pah gjuhën e papërshtatshme seksiste, mungesën e shkallës së ankesave dhe kuotën për ndëshkimin e deputetëve në rast të sjelljeve të papërshtatshme.³⁵

Në frymë të ofrimit të zgjidhjeve, KDI kishte rekomanduar ngritjen e masës ndëshkimore, derisa në Raportin e Kuvendit për vitin 2023 rekomandimi ishte saktësuar në rritje të masave ndëshkimore deri në 50% të pagës.³⁶ Përfundimisht, ky ka ardhur edhe si propozim në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion,³⁷ kurse modalitetet e ndëshkimit janë zgjeruar në disa forma të reja, sikurse: suspendim me pjesëmarrje deri në tri seanca.³⁸ Me këtë përmbajtje Kodi është votuar në Komisionin për Legjislacion, ndërsa mungesa e votimit përfundimtar në seancë, vë në sipërfaqe mosgatishmërinë e Kuvendit për të adaptuar dokumentin në fjalë.

2.2 Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve

Iniciativat për Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve kishin filluar gjatë vitit të kaluar, ndërsa punimet në draftim vazhduan gjatë këtij viti. Në proces të draftimit, Komisioni kishte kërkuar ndihmën në kuptim të ofrimit të ekspertizës nga Këshilli i Evropës, analizë kjo që kishte vlerësuar se versioni fillestar përmban mangësi serioze. Përmbajtësisht, ky vlerësim gjykon se iniciativës për rirregullimin e kompetencave të KPM-së i mungon qartësi fillestare, procesi nuk aktivizohet nga një koncept-dokument që do të ofronte një analizë të detajshme për mangësitë dhe synimet për përmirësim. Po ashtu, analiza qartëson se, gjuha normuese është e paqartë dhe lë hapësirë jo të përkufizuar

saktësisht për ndëshkim, pa ofruar shpjegime se si do të mund të kufizoheshin gjobitjet potenciale – rrjedhshëm, hapësirë të madhe për interpretim arbitrar.³⁹ Kalimthi analiza trajton një numër çështjesh, sikurse vështirësitë për luftimin e lajmeve false; barra e tepërt që projektligji vë mbi mediat online; koncepti i "shërbimeve mediatike online audio-vizuale", i cili është i panjohur për ligjin evropian.

Një perspektivë tjetër e kësaj analize, fokusohet tek ndikimi që Projektligji do të ketë drejtpërdrejt mbi Komisionin e Pavarur të Medieve, në kuptim të raportit ndërmjet politikës dhe institucionit të KPM-së. Përgjithshëm, shqetësimi qendror është pavarësia e rrezikuar e këtij institucioni, meqenëse në kornizën ekzistuese, të gjithë anëtarët e KPM-së mund të zgjidhen gjatë një mandati dhe varësia politike e këtij institucioni, mund të vjen në shprehje si një nga problemet praktike në të ardhmen.⁴⁰

Megjithëse vërejtjet ishin integrale për përmbajtjen mundshme dhe diskutimi rreth tyre nuk dukej të jenë konsumuar, përfundimisht Projektligji për KPM-në u miratua gjatë këtij sesioni. Kryetari i Komisionit Parlamentar për Administratë, Valon Ramadani, shprehu opinionin se rekomandimet, të gjitha ishin trajtuar, duke deklaruar se nga 93 komente, kishte 93 amandamentime.⁴¹ Kurse organizata dhe persona publik të ndryshëm dolën në kundërshtim. Mbi bazë të pretendimeve për ndikimin politik mbi organin e KPM-së, kontestimin e këtij projektligji, partitë opozitare PDK dhe LDK, vendosën t'a vazhdojnë në Gjykatën Kushtetuese.⁴²

2.3 Hartimi i Projektligjit të ri për Këshillin Prokurorial

Në këtë sesion, një nga çështjet polemizuese në punimet e Kuvendit ishte edhe reformimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Përreth temës, pati dilema edhe më të theksuara, për shkakun e ekzistencës së një ligji për të njëjtin Këshill, të cilin përfundimisht Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur të pavlefshëm.⁴³ Dilema kryesore qyshkur është filluar draftimi i tij, ka qenë rikonfigurimi i përbërjes së Këshillit. Në versionin e ri, parashihet një përbërje prej 7 anëtarëve në këtë organ, derisa 3 prej tyre do të jenë anëtarë joprokurorë. Për më tepër, si modalitet vendimmarrje, në raste të bllokimit të mundshëm është vlerësuar shumica e thjeshtë (prej së paku 4 anëtarësh) të mjaftojë për zhvillimin e procedurës. Në fund të procesit, të pakënaqur me zgjedhjet e bëra mbi Këshillin Prokurorial i Kosovës, organ që vlerësoi se përmes këtij rregullimi po synohet vënia e Këshillit në ndikim të politikës.⁴⁴ Kurse, partitë opozitare, ndonëse gjatë procesit të draftimit nuk ishin treguar aspak bashkëpunuese, përfundimisht e dërguan sërish Ligjin në Gjykatën Kushtetuese për vlerësim.⁴⁵



PUNA E KOMISIONEVE PARLAMENTARE





Komisionet parlamentare gjatë sesioni pranveror të vitit 2024 kanë mbajtur 193 mbledhje dhe dëgjime publike.⁴⁶ Ndërsa komisionet hetimore kanë mbajtur 36 mbledhje. Gjatë sesionit pranveror të vitit të kaluar komisionet kishin mbajtur 221 mbledhje.⁴⁷ Nga çdo perspektivë, legjislatura ka treguar rënie në cilësi të punës. Gjatë sesionit të vitit të kaluar, komisionet kishin trajtuar 33 projektligje dhe 35 raportime nga përfaqësuesit e ekzekutivit.⁴⁸ Aktiviteti i komisioneve edhe në këta tregues ka treguar rënie, ata këtë sesion trajtuan 16 projektligje, ndërsa kishte vetëm 15 raportime.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere

Edhe në këtë sesion puna e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere shquhet për nga volumi. Ky komision, përgjatë gjithë legjislaturës ka pasur agjendë të ngjeshur, trend ky që është vënë re edhe gjatë sesionit të fundit. Gjatë këtij sesioni komisioni ka zhvilluar 16 mbledhje⁴⁹, kurse në sesionin pranveror të vitit të kaluar kishte organizuar 23 sosh.⁵⁰

Subjekti i punës së këtij trupi, ishte mjaft i gjerë për nga përmbajtja dhe i ndryshëm për nga funksioni. Komisioni ka ushtruar funksionin e tij legjislativ në masë të kënaqshme, duke miratuar 28 Projektligje, duke përfshirë edhe raportet për projektligje të komisioneve tjera, 7 Marrëveshje Ndërkombëtare dhe një Projekt-Kod. Këto projektligje trajtojnë çështje të ndryshme – përmbajtja e të cilave rregullon fusha si Trafiku Rrugor, Burimet e Ripërtërishme, Agjencinë e Inteligjencës, Regjistrin e Pronarëve Përfitues, Sportin, Rininë, etj.

Kundrejt ekzekutivit, Komisioni, ka organizuar dy mbledhje raportimi, në të cilën Ministri i Financave, Hekuran Murati raportoi për dy çështje: realizimi i të hyrave buxhetore për vitin 2023 dhe borxhi publik.⁵¹ Ngjashëm, ministri Murati, mori pjesë në prezantimin e Projekt-Kodit Doganor dhe të Akcizave,⁵² në prezantimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të Projektligjit për Ndarjet Buxhetore. Po ashtu, gjatë këtij sesioni, pranë Komisionit për Buxhet, në lidhje me takimin në Bruksel të delegacionit të Bankës Qendrore dhe përfaqësuesit të Bashkimit Evropian Miroslav Lajčak, ka raportuar edhe Guvernatori i Bankës Qendrore, Ahmet Ismaili.⁵³

Në kuadër të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës, Komisioni ka trajtuar 25 raporte financiare, plane të performancës apo kërkesa buxhetore të institucioneve, agjencive apo

komisioneve të ndryshme publike. Në këtë pikë, për tu shquar është refuzimi për të votuar, në një formë të përgjithësuar të gjithë raportet – praktikë kjo që aplikohet në punën e komisioneve të Kuvendit. Komisioni, në disa raste ka kërkuar revidimin e dokumentacionit të prezantuar para deputetëve, me arsyetimin e përmbajtjes së mangët. Shembull i trajtimit të kësaj natyre është refuzimi për të votuar planin vjetor të performancës së Organit Shqyrtues të Prokurimit apo të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.⁵⁴

Problematike në punën e Komisionit mbetet trajtimi i vonuar i raporteve financiare të organeve publike. Komisioni për Buxhet, gjatë këtij sesioni, ka trajtuar 8 raporte financiare të vitit 2022, me më shumë se 1 vit vonesë. Ngjashëm, në trajtimin e raporteve apo pasqyrave financiare, Komisioni, pas mbledhjes shqyrtuese ka tejkaluar kufirin e një periudhe optimale për të votuar materialin e shqyrtuar.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ndonëse është një trup i përhershëm i ngarkuar me një fushëveprim shumë të rëndësishëm, praktika e tij nuk konsiston në një agjendë që do të përmbushte këtë funksion. Në dallim nga komisionet e tjera të përhershme, Komisioni për Komunitete, nuk ka zhvilluar aktivitet të ngjeshur – gjatë gjithë sesionit, ka mbajtur vetëm 6 mbledhje,⁵⁵ numër ky që tregon trend të rënies, meqë ky Komision gjatë sesioni pranveror të vitit të kaluar kishte mbajtur 11 mbledhje.⁵⁶

Mungesa e tetë deputetëve nga radhët e komunitetit serb në këtë komision ka vazhduar edhe gjatë këtij sesioni. Ngjarje kjo që përveç ka krijuar vështirësi praktike në krijimin e kuorumit të nevojshëm, ka privuar Komisionin prej një



boshti të deputetëve të komuniteteve, prania e të cilëve është e domosdoshme, për të rritur legjitimitetin e punës së këtij komisioni.

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni, ka miratuar 16 projektligje duke përfshirë edhe raporte të projektligjeve të komisioneve tjera, dhe një marrëveshje ndërkombëtare. Megjithëse numri i këtyre iniciativave ligjore është i kënaqshëm, trajtimi i tyre ka lënë për të dëshiruar. Në përgjithësi, puna e Komisionit konsiston në votimin e secilit projektligj që dorëzohet pranë, pa ndonjë debat mbi përmbajtjen e tyre. Kryesisht, mbledhjet e këtij Komisioni vazhdojnë të mbesin takime për të votuar rendin e ditës.

Për më tepër, kur vlerësohet mungesa e aktivitetit mbikëqyrës të Komisionit, puna e tij bëhet më shumë e denjë për kritika. Asnjë zyrtar i ekzekutivit apo ndonjë institucioni tjetër publik nuk është ftuar për të informuar Komisionin në lidhje me gjendjen e të drejtave të komuniteteve apo ndonjë temë të ndërlidhur. Në kontekstin e gjendjes së tensionuar në veri të vendit, lokalitet ku shumicë janë banorët nga komuniteti serb, komisioni do të duhej të bënte më tepër për tu informuar rreth kësaj gjendje. Komisioni si një organ i themeluar për të trajtuar çështjet që i përkasin komuniteteve pakicë në Kosovë, do të duhet të luante një rol më aktiv në tema kombëtare, për shembull, lidhur me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Mbetja e kësaj trupe shumë të rëndësishme parlamentare krejtësisht jashtë debatit shpërfaqë një mungesë të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës, performancë kjo që duhet të vendoset në qendër të kritikës.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

Komisioni për Legjislacion, si një nga komisionet e përhershme të Kuvendit, luan rol kyç në realizimin e agjendës legjislative. Puna e këtij Komisioni përherë është intensive, trend ky i shfaqur edhe gjatë këtij sesioni. Kësisoj, komisioni në sesionin pranveror të këtij viti ka mbajtur 17 mbledhje,⁵⁷ kurse në sesionin pranveror të vitit paraprak kishte mbajtur 20 mbledhje.⁵⁸

Pjesa më e madhe e veprimtarisë së komisionit gjatë sesionit pranveror kufizohet në ushtrimin e funksionit ligjvënës. Komisioni ka miratuar – qoftë në lexim të parë apo të dytë – 29 projektligje apo raporte të tyre, 4 nga këta vetëm në parim, derisa procesi i draftimit të tyre po

vazhdon në grupet punuese të themeluara nga Komisioni. Për tu shquar është fakti se Komisioni ka themeluar 9 grupe punuese për hartimin e projektligjeve të ndryshme, sikurse: Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Projektligji për Noterinë, për Pasurinë e Sekuestruar dhe ai për të Drejtat Pronësore të Shtetasve të huaj.

Hartimi i Kodit të Sjelljes për deputetët, gjithashtu paraqet një nga angazhimet e Komisionit gjatë këtij sesioni. Hartimi i këtij dokumenti kishte filluar gjatë vitit të kaluar, kurse përfundimisht me disa propozime për ndryshim është miratuar në këtë Komision.⁵⁹ Një shpjegim më të detajshëm, në lidhje me përmbajtjen e Kodit, e gjeni në kapitullin e këtij raporti për zhvillimet e veçanta gjatë sesionit.

Në pikëpamje të mangësive të shfaqura, mungesa e debatit brenda komisionit përfaqëson të metën kryesore. Mbledhjet, zakonisht, janë ftuar në ditën e seancës, gjë që ka krijuar kufizimin kohor për të zhvilluar debatin mbi çështjet kundërtënëse. Kjo vërejtje është shprehur disa herë nga anëtarët deputetë që vinë nga partitë opozitare. Deputeti Driton Selmanaj, në disa raste ka shprehur shqetësimin për këtë formë të mbledhjeve.⁶⁰ Në formë të ngjashme, deputeti Besnik Tahiri ka kritikuar mungesën e debatit brenda komisionit.⁶¹ Votimi brenda komisionit do të duhej të paraprihej nga debati i mjaftueshëm që mundëson shprehjen e dallimeve dhe të refuzonte aplikimin e praktikës së votimit të shpejtë, në mbledhje të shkurtra para seancave.

Komisioni për Integrim Evropian

Si një nga katër komisionet e përhershme, Komisioni për Integrim Evropian, luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e materialit të agjendës legjislative, nga këndvështrimi i përputhshmërisë me agjendën e integritimit evropian. Komisioni për Integrim Evropian nuk pati agjendë të ngarkuar gjatë këtij sesioni – ai zhvilloi vetëm 11 mbledhje⁶² derisa në sesionin pranveror të vitit të kaluar kishte zhvilluar 12 mbledhje.⁶³

Në kuptimin e veprimtarisë ligjvënëse, Komisioni, ka shqyrtuar 24 projektligje duke përfshirë edhe raporte të Projektligjeve nga komisionet tjera, dhe 3 marrëveshje ndërkombëtare. Në masë të konsiderueshme, mbledhjet e kësaj trupe, shquhen për mungesë të debateve mbi përmbajtjen e projektligjeve; kurse shpeshherë mbledhjet shndërrohen në përballje ndërmjet pushtetit dhe opozitës, ku deputetët nuk kursehen as në përdorim të fjalorit të papërshtatshëm.





Numri i mbledhjeve të këtij komisioni është nën pritshmëritë minimale që ky komision duhet të plotësojë. Ngjashëm, trendi i rënies së mbledhjeve nga viti i kaluar, paraqet një të dhënë që duhet të kritikohet.

Në një nga tre mbledhjet e organizuara nga Komisioni për Punë të Jashtme, ka raportuar zëvendëskryeministri Besnik Bislimi. Subjekt i kësaj mbledhje raportuese ishte gjendja e procesit dialogues me Serbinë.⁶⁷ Ndonëse ka pasur një numër të dështimeve në politikën e jashtme, Komisioni ka qëndruar i pa interesuar për këto zhvillime – nuk ka ftuar për raportim asnjëherë ministren e punëve të jashtme, Donika Gërvalla-Scharwz, për raportim pranë deputetëve.

Arsyet për pasivitetin e këtij komisioni janë të paqarta, porse fakti në vetë është evident, numri i mbledhjeve të organizuara nga ky komision është tejet i ulët. Komisioni, në praktikën e përditshme të tij, nuk duhet të mjaftohet me takime të natyrës diplomatike por me planifikim më përmbajtësor të punës.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Komisioni funksional për Arsim, në sesionin pranveror, ka zhvilluar aktivitet të ngjeshur – me 17 mbledhje dhe 9 dëgjime publike të organizuara. Gjatë sesionit pranveror të vitit paraprak, ky komision kishte mbajtur 13 mbledhje dhe 2 dëgjime publike.⁶⁸ Rrjedhshëm, mund të përfundohet se, përveç që ka treguar aktivitet për tu vlerësuar, komisioni ka dëshmuar edhe një trend të rritjes së performancës.

Komisioni ka shqyrtuar 7 projektligje apo raporte të tyre, që përfshihen në fushën e komisionit. Po ashtu ka marrë pjesë drejtpërdrejt në hartimin e 4 projektligjeve, për draftimin e të cilëve ka mbajtur dëgjime publike duke aplikuar praktika të rekomandueshme të përfshirjes të sa më shumë qytetarëve, grupeve dhe komuniteteve të prekura nga projektligjet në fjalë.

Një nga çështjet e rëndësishme që ky komision ka trajtuar gjatë sesionit pranveror ishte Statuti i Universitetit të Prishtinës. Në një mbledhje, gjatë muajit maj, pas prezantimit nga ana e ministres Arbërie Nagavci dhe rektorit Qerim Qerimi, komisioni vendosi që atë dokument t'a votojë, duke e dërguar në seancë.⁶⁹ Ndërsa, për tu vlerësuar është përpjekja e komisionit për tu informuar për çështje të ndryshme. E tillë ishte, mbledhja diskutuese e organizuar nga komisioni për gjendjen e edukimit fizik dhe

Gjatë këtij sesioni, Komisioni për Integritet, në funksion të angazhimit mbikëqyrës ka ftuar për raportim dy anëtarë të Qeverisë. Fillimisht, ministrja Rozerta Hajdari, kishte raportuar për përmbushjen e objektivave që kanë të bëjnë me integritetin evropian.⁶⁴ Ndërsa, edhe zëvendëskryeministri i parë Besnik Bislimi, raportoi pranë Komisionit, ku është trajtuar Programi Kombëtar për Integritet Evropian.⁶⁵

Një segment tjetër i punës së anëtarëve të këtij Komisioni është diplomacia parlamentare që realizohet nëpërmjet takimeve, vizitave të deputetëve, pjesëmarrjes në takime ose konferenca ndërkombëtare, etj. Kësisoj, deputetët e Komisionit për Integritet kanë vazhduar aktivitetin diplomatik të këtij lloji edhe gjatë këtij sesioni.

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë

Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, gjatë sesionit pranveror, ka zhvilluar vetëm 3 mbledhje, derisa në sesionin pranveror të vitit të kaluar ky komision kishte mbajtur 7 mbledhje.⁶⁶ Një pjesë e konsiderueshme e punës së Komisionit është fokusuar në takime, duke organizuar rreth 15 takime të karakterit diplomatik. Në këto raste, deputetët, kanë mirëpritur në takime figura diplomatike të ndryshme, gjersa janë diskutuar tema që bien në fushë veprimtarinë e komisionit.



institucionet ligj-zbatuese në sektorin e shërbimit të ujit.⁷³ Po ashtu, në mënyrë që të informohet për planifikimet e ekzekutivit, komisioni në dy raste ka ftuar ministren Artane Rizvanolli për raportim për tema si gjendja në Ministrinë e Ekonomisë dhe planifikimet e kësaj ministrie dhe lidhur me performancën e ndërmarrjeve publike.

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Komisioni për Shëndetësi përfaqëson një trup rëndësishëm parlamentar, funksioni i të cilit është jetik, qoftë në procesin e draftimit të ligjeve apo edhe të mbikëqyrjes së zyrtarëve publik në sektorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale. Gjatë këtij sesioni, komisioni ka mbajtur 13 mbledhje, ndërsa në sesionin pranveror të vitit të kaluar kishte mbajtur 22 mbledhje.⁷⁴ Kësisoj, mund të vërehet një rënie në aktivitet në kuptimin numerik, mirëpo një pjesë e punës së komisionit gjatë këtij viti konsiston në tryeza apo takime informuese.

Ndonëse funksioni parësor i këtij komisioni është legjislativ, gjatë këtij sesioni ai nuk ka shqyrtuar asnjë projektligj, në përjashtim të trajtimit të raportit përfundimtar për Projektligjin për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar Mjekësor, në fillim të muajit janar.⁷⁵ Në këtë kuptim, mungesa e angazhimit legjislativ, paraqet problemin kryesor të komisionit gjatë këtij sesioni.

Në funksion të mbikëqyrjes, komisioni [vazhdueshëm] ka ftuar për raportim anëtarë nga Qeveria apo zyrtarë të ndryshëm që ushtrojnë veprimtarinë në fushën shëndetësore apo mirëqenien sociale. Fillimisht, Komisioni ka ftuar në seancë raportimi ministrin Arben Vitia, për të trajtuar Strategjinë Legjislative të Ministrisë së Shëndetësisë.⁷⁶ Ndërsa, për raportim ishte ftuar edhe ministri Hekuran Murati, ku është diskutuar çështja e skemave sociale dhe pensionale.⁷⁷

Po ashtu, komisioni ka zhvilluar mbikëqyrjen e zbatimit të dy ligjeve: Ligjin për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe Ligjin për Ndërmarrjet Sociale. Derisa, në mbledhjet e tij përgjatë sesionit ka pasur një numër të takimeve informuese ku kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme apo kategorive shoqërore, si përfaqësuesit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës apo përfaqësuesit e logopedëve.

shëndetësor në shkollat në Kosovë, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Fakulteti i Edukimit Fizik të Universitetit të Prishtinës dhe Ministria e Arsimit.⁷⁰

Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti

Komisioni për Ekonomi, paraqet një trup të rëndësishëm në punën parlamentare – përveç funksionit legjislativ, mbikëqyrja dhe filtrimi i planeve të performancës të kompanive dhe organizatave publike, përfshihen në fushëveprimin e komisionit. Gjatë këtij sesioni komisioni ka mbajtur 19 mbledhje, 3 dëgjime publike dhe 1 dëgjim mbikëqyrës.⁷¹ Kurse në sesionin pranveror të vitit 2023, kishte mbajtur 24 mbledhje dhe 3 dëgjime publike.⁷²

Gjatë këtij sesioni, ky komision ka shqyrtuar 8 projektligje apo raporte të tyre, një nga të cilët ishte marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa ka trajtuar 16 raporte vjetore dhe plane të performancës. Të dy këto veprimtari përfaqësojnë angazhimin kryesor të komisionit në përmbushje të funksionit legjislativ dhe mbikëqyrës.

Megjithatë, puna mbikëqyrëse e Komisionit të Ekonomisë nuk kufizohet tek këto raporte – Komisioni ka organizuar një dëgjim mbikëqyrës për zbatimin e legjislacionit nga





Përfundimisht, në gjuhë kritike mund të pohohet se aktiviteti i Komisionit për Shëndetësi ka çaluar në kuptimin përmbajtësor. Përveç mungesës së aktivitetit legjislativ, veprimtaria mbikëqyrëse brenda punës së komisionit ka lënë shumë për të dëshiruar në kuptim të mënyrës së realizimit. Deputetëve të partisë në pushtet, në seancat raportuese të ministrave iu ka munguar vullneti i njëmendte për mbikëqyrje – sjellja e tyre ka qenë më tepër prej vartësi të ekzekutivit.

Komisioni për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim

Gjatë sesionit pranveror, Komisioni për Mjedisin ka mbajtur 9 mbledhje dhe 1 dëgjim legjislativ,⁷⁸ kurse në sesionin pranveror të vitit të kaluar kishte mbajtur 15 mbledhje dhe 2 dëgjime publike.⁷⁹ Përmbajtësisht, mund të pohohet se angazhimi i Komisionit për Mjedis gjatë këtij sesioni, përveçse ka rënë në kuptimin numerik, edhe në kuptimin cilësor të punës, ka shënuar trende rënieje.

Komisioni përgjatë sesionit, në faza të ndryshme, ka shqyrtuar 10 projektligje, sikurse Projektligji për Rrugët, Projektligji për Administrimin e Banesave dhe Lagjeve, ai për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Projektligji për Performancën Energjetike të Ndërtesave. Mungesa e veprimtarisë mbikëqyrëse, qoftë thirrjes në raportim të anëtarëve të ekzekutivit apo monitorimi i zbatimit të

ligjeve, përfaqëson të metën kryesore të këtij komisioni. Në kuptim të listimit të aktiviteteve ku komisioni duhet të performojë më mirë, mbikëqyrja zë vend kryesor. Më tepër se thirrja për të zbatuar drejtpërdrejt kompetencën e mbikëqyrjes, të përcaktuar nga Rregullorja, komisioni duhet t'i përkushtohet punës së jashtme dhe monitoruese, meqë fushëveprimtaria e komisionit konsiston çështje të ndërlydhura me mjedisin.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media

Gjatë kësaj periudhe në tërësi komisioni për Administratë Publike ka mbajtur 9 mbledhje, 9 dëgjime legjislativ dhe 4 dëgjime mbikëqyrëse,⁸⁰ kurse gjatë sesionit pranveror të vitit të kaluar kishte mbajtur 17 mbledhje.⁸¹ Në kuptim të aktivitetit legjislativ, komisioni ka trajtuar në tërësi 5 projektligje.

Puna e këtij Komisioni filloi me një çështje të rëndësishme, trajtimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Medieve në lidhje me lejimin e transmetimit të kanaleve "Arena Sport".⁸² që prodhoi paqartësi është tërësisht i denjë. Hetimi nga komisioni, ka vënë në pah faktin se për transmetimin e kanalit televiziv, nuk ka ekzistuar licencim nga kompania televizive Artmotion dhe transmetimi ka qenë i paligjshëm.⁸³ Në dritë të këtij fakti të zbuluar gjatë seancave të dëgjimit mbikëqyrës, i cili ka qenë i panjohur edhe për KPM-në,⁸⁴ transmetimi i përmbajtjes së përfolur është ndaluar.⁸⁵ Përfundimisht, ndonëse hera-herës me një gjuhë jo të përshtatshme, dëgjimi mbikëqyrës për vendimin e KPM-së, i organizuar në 4 seanca, paraqet një nga raste kur deputetët e Kuvendit të Kosovës, kanë ushtruar suksesshëm funksionin mbikëqyrës.



Në anën tjetër, komisioni, në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes në rrethana të ngjashme të një papërgjegjësie në fushën e medieve, refuzoi të hetojë rastin Radio Televizionit të Kosovës. Në edicionin kryesor të lajmeve të datës 22 korrik, RTK kishte publikuar një lajm nga mediumi boshnjak 'Slobodna Bosna', ku pretendohet në një formë të pa argumentuar se financimi i dy medimeve private në Kosovë, 'Periskopi' dhe 'Nacionale', buron nga Serbia.⁸⁶ Në rrethana të zbulimit të disa prapaskenave të cilat vënë dyshime mbi përzgjedhjen e këtij lajmi⁸⁷ Komisioni për Administratë, do të duhej të vazhdonte praktikën mbikëqyrëse, duke thirrur një seancë mbikëqyrjeje, platformë kjo ku përveç intervistimit të të gjithë akterëve – Bordit, Drejtorit të RTK-së, redaktorëve, etj. – do të mund të veprohej drejt masave ndëshkuese për një lëshim të kësaj natyre. Kësisoj, Komisioni ka vepruar në një mënyrë selektive, duke dështuar që në një formë të ekuilibruar të përmes mbikëqyrjes precize, të vë para llogarisë të përzgjedhurit e Kuvendit, pa dallim të afërsisë politike.

Një pjesë e shqar e punës së Komisionit për Administratë, po ashtu, kanë qenë dëgjimet legjislativ. Komisioni ka mbajtur 7 dëgjime të tilla, të cilat janë kufizuar për marrjen e kërkesave, vlerësimeve dhe opinioneve të kategorive të ndryshme shoqërore për Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve. Ndonëse pjesa më e madhe e tyre,

shtatë sosh organizuar për Projektligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve, versioni përfundimtar i projektligjit nuk pajtoi kundërthëniet ndërmjet grupeve pjesëmarrëse; derisa nga organizatat që veprojnë në fushën e medieve, qëllimi i pushtetit të Vetëvendosjes është vlerësuar të jetë vënia në kontroll e institucionit të KPM-së⁸⁸. Ky projektligj ishte miratuar në Kuvendin e Kosovës në seancën e 27 qershorit.⁸⁹ Një shtjellim më të gjerë të përmbajtës së tij e gjeni në pjesën e zhvillimeve të veçanta të këtij sesioni.

Puna e këtij Komisioni, në pikëpamje të përgjithshme, ka përjetuar një ngritje cilësore gjatë këtij sesioni. Angazhimi i Komisionit, nuk është kufizuar në mbledhje, mbajtja e të cilave është e obligueshme nga domosdoshmëria për të trajtuar ligjet; ai ka zhvilluar edhe dëgjime mbikëqyrëse dhe dëgjime legjislativ apo konsultuese. Gjatë dëgjimeve mbikëqyrëse, në disa raste, ka pasur probleme të natyrës teknike, si mos shpërndarja e disa dokumenteve me kohë, mungesa e përkthimit qoftë të dokumenteve apo përkthimit simultant. Në këtë aspekt, komisioni duhet të fokusohet të përmirësojë punën. Ngjashëm, Komisioni, nuk duhet të mjaftohet me numër të lartë të dëgjimeve legjislativ, meqë mënyra e trajtimit të inputeve të marra nga këto takime paraqet çështjen thelbësore.

Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes

Fushë veprimtaria e Komisionit për Çështje të Sigurisë përveçse është e rëndësishme për nga subjekti që trajton, ajo është mjaft e gjerë dhe kërkon angazhimin për t'i mbuluar të gjitha funksionet. Në praktikë, komisioni në fjalë, gjatë sesioneve të kaluara nuk kishte qenë aktiv, derisa pjesërisht, këtë sesion ka treguar përmirësim. Komisioni gjatë këtij sesioni ka mbajtur 11 mbledhje, ⁹⁰ kurse në vitin e kaluar, në sesionin pranveror, kishte mbajtur 9 mbledhje.⁹¹

Në pikëpamje të aktivitetit, mund të pohohet se agjenda e komisionit është përbërë nga veprimtari legjislativ dhe mbikëqyrëse. Në ushtrim të funksionit legjislativ, Komisioni, ka shqyrtuar 9 projektligje, në faza të ndryshme, numër ky që mund të vlerësohet si i kënaqshëm. Ndërsa, mbikëqyrja e komisionit ishte, në formë të ngjashme, mjaft e shqar në tërësinë e aktivitetit të Komisionit. Pranë Komisionit, kanë raportuar krerët e institucioneve të sigurisë sikurse: Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla; Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci; Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Bashkim Jashari; Drejtori






Agjenda e Komisionit, pothuajse, në çdo sesion përbëhet nga aktivitetet i ngjashëm. Pranë Komisionit ofrojnë informacione kategori të ndryshme shoqërore, derisa në përfundim rezultatet e këtyre diskutimeve nuk sjellin ndonjë ndikim përmbytësor në agjendën politikbërëse të komisionit. Këtë sesion, zakonshëm, Komisioni ka pritur në një mbledhje informuese përfaqësuesit e Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur, sikurse që priti përfaqësuesit e grupeve të paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve, porse përfundimisht, gjetjet nga këto takime nuk shndërrohen në kërkesa që komisioni dhe anëtarët e tij artikulojnë përballë përfaqësuesve të ekzekutivit apo autoriteteve tjera. Mos integrimi i të dhënave të tilla, në procesin politik brenda-parlamentar, përveçse lë jashtë trajtimit tema të rëndësishme në fushë e të drejtave të njeriut, ai shpërfaqë praktikën jorezultative të punës së komisionit.

Një çështje tjetër që duhet të theksohet është qasja krejtësisht pasive e këtij komisioni në raport me Projekt-Kodin Civil. Kësisoj, në rrethana të mungesës së qartësisë, kjo temë aq e denjë për t'u shqyrtuar, nuk do të duhej të kalonte pa një dorë kontribuuese të komisionit. Ndërsa, edhe më problematike bëhet roli i këtij Komisioni në raport me këtë dokument ligjor, kur mendohet qëndrimi i Kryetares së Komisionit, Duda Balje. Së bashku me konsideratën për rëndësinë jetike të shprehjes së lirë të mendimit pa qenë i/e paragjykuar, duhet [domosdoshëm] të pohohet se puna e Komisionit në tërësi cenohet, nëse pozicioni udhëheqës zotërohet nga një person që duke u mbështetur në bindje të saj partikulare, kundërshton një Kod që avancohet drejtat e njeriut.

i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha; si dhe Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Kushtrim Hodaj. Përgjithshëm, temë e diskutimi ishin zhvillimet në fushën e sigurisë, ndërsa vlen të theksohet raportimi i ministrit Sveçla⁹² për punët dhe zhvillimet gjatë vitit 2023 dhe raportimi i ministrit Maqedonci⁹³ për zhvillimet në fushën e sigurisë, me theks të veçantë investimet në këtë fushë.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës, për Persona të Pagjetur dhe Peticione

Agjenda e Komisionit për të Drejtat e Njeriut gjatë këtij sesioni, është karakterizuar me një rënie në numrin e mbledhjeve në krahasim me sesionin e njëjtë të vitit të kaluar. Komisioni këtë sesion ka mbajtur 15 mbledhje⁹⁴, ndërsa vitin e kaluar kishte mbajtur gjithsej 20 mbledhje.⁹⁵ Nga një këndvështrim më i përgjithshëm, mangësitë në punën e komisionit më shumë se në kuptim të numrave janë mungesë e përfshirjes në procesin legjislativ. Ndonëse ka trajtuar disa raportime dhe peticione, puna e komisionit mbaron aty.



Në anën tjetër, duke pasur në mendje, vështirësitë në zbatimin e ligjeve që bien në fushën e të drejtave të njeriut, Komisioni do të duhej të bënte më tepër për mbikëqyrjen e zbatueshmerisë së ligjeve. Në anën tjetër, praktika e takimeve dhe vizitave në institucione të ndryshme është për tu vlerësuar, por duke njohur pamjaftueshmërinë e saj.

Përfundimisht, Komisioni nuk ka dhënë rezultatin e kërkuar, veçanërisht ndërlidhja e veprimtarisë së saj mbikëqyrëse me atë ligjvënëse, mbetet sfida kryesore.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Aktiviteti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave, gjatë sesionit pranveror, ka qenë krejtësisht tipik për fushëveprimtarinë e tij. Komisioni ka zhvilluar 14 mbledhje,⁹⁶ derisa në sesionin pranveror të vitit 2023 kishte zhvilluar 19 sosh.⁹⁷ Krahasimisht, në kuptimin e volumit, puna e këtij Komisioni ka treguar rënie, të evidentueshme lehtësisht.

Derisa në sesionin pranveror të vitit 2023 ky komision kishte shqyrtuar 19 raporte auditimi apo të performancës⁹⁸, këtë sesion ka shqyrtuar 14 raporte të tilla. Duhet të theksohet së një pjesë e tyre janë raporte auditimi për projekte apo çështje të ndryshme, si për shembull, Raporti për Miniera dhe Minerale, Raporti i Performancës "Prokurime të Negociuara pa Publikim", apo Raporti i Performancës "Sistemet e Informacionit në Kompaninë e Ujësjellësit Rajonal Prishtina". Kurse, një pjesë tjetër e raporteve që ky komision ka shqyrtuar i takojnë institucioneve të ndryshme, sikurse Posta e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, etj.

Megjithëse volumi i punës ka treguar rënie, mund të pohohet se në tërësi aktiviteti mbikëqyrës, në kuptim të shqyrtimit të raporteve financiare ishte i bollshëm.



Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka pasur trend të rënies sa i përket numrit të mbledhjeve gjatë këtij sesioni. Ky komision, përgjatë sesionit ka mbajtur 6 mbledhje.⁹⁹ Ndërsa, gjatë sesionit të njëjtë, në vitin e kaluar, kishte zhvilluar 9 mbledhje.¹⁰⁰

Aktiviteti i këtij komisioni, në formë krejt të zakonshme, edhe gjatë këtij sesioni është kufizuar në raportimin e udhëheqësit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Petrit Ajetit. Ky i fundit, pranë këtij komisioni, ka raportuar tre herë, derisa seancat kanë qenë të pa qasshme për publikun.

Në kuptim të aktivitetit legjislativ, puna e këtij komisioni është inekzistente.





TRANSPARENCA E KUVENDIT


Nga këndvështrimi i transparencës, gjendja gjatë sesionit pranveror ka pësuar ndryshime, meqë Kuvendi, zyrtarisht ka përmbyllur procesin e vendosjes së aparaturave të reja të votimit elektronik. Gjatë periudhës që ky proces po vazhdonte, ishin shfaqur dyshimet për gabime në numërimin fizik të votave – derisa deputetët kishin ngritur mëdyshjet e tyre për procesin e votimit të dy projektligjeve.¹⁰¹ Më saktësisht, deputeti Visar Korenica, kishte kërkuar për sqarimin votimin e Projektligjit për Fertilizim të Asistuar Mjekësor dhe Projektligjin për Tekste Shkollore, mbi bazë të pretendimeve të numërimit të gabuar. Kësaj, procesi i administrimit të votimit të deputetëve ishte zhytur në paqartësi, nga të cilat vetëm kthimi i aparaturës elektronike mund të rikthente besueshmërinë e domosdoshme për një proces politik me legjitimitet të plotë.

Porse, çështja e transparencës në Kuvend nuk mund të reduktohet tek votimi elektronik. Përveç kësaj teme

qendrore, ka një mungesë të veprimtarisë transparente të komisioneve, në kuptim të mospublikimit të dokumenteve pasuese, sikurse planet e punës, transkriptat apo procesverbalet. Megjithatë publikimin e tyre e obligon Rregullorja,¹⁰² të dhënat tregojnë që numri i dokumenteve të publikuara është më i vogël se numri i mbledhjeve. Gjatë vitit të kaluar, në sesionin pranveror, nga 221 mbledhje, për vetëm 143 prej tyre ishin publikuar dokumentet pasuese të kërkuara në platformën e Kuvendit. Kurse, trendi i ngjashëm vazhdon edhe këtë vit, nga gjithsej 229 mbledhje dhe dëgjime, vetëm për 140 prej tyre (60%), janë publikuar dokumentet pasuese të mbledhjeve.

Në tabelën e mëposhtme gjeni të dhënat për aktivitetet e komisioneve dhe publikimin e procesverbaleve nga ana e tyre.¹⁰³

TABELA 1.7 – Publikimi i procesverbaleve të Komisioneve në krahasim me mbledhjet e mbajtura



Sesioni pranveror 2024

Sesioni pranveror 2023





Sesioni pranveror 2024

Sesioni pranveror 2023

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione



Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike



Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë



Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore



Komisioni Hetimor për Marrëdhënien e Punës në Shërbimin Diplomatik



Komisioni Hetimor për Tekstet Shkollore



GJITHSEJ



Ndonëse, në pikëpamje të transparencës, situata është e papranueshme tek disa komisione, gjendja tek komisionet hetimore apo komisionet ad-hoc, mbetet pakrahasimisht më e mangët. Veprimtarinë e tyre, Kuvendi nuk e pasqyron askund, derisa nuk publikon as lajmet njoftuese për takimet e këtyre trupave dhe temat e trajtuara. Momentalisht,

këto komisione funksionojnë krejtësisht në praktika jo transparente: mungojnë portofoliot e këtyre komisioneve, ku do të mund të publikoheshin transkriptet dhe dokumentet pasuese të mbledhjeve të mbajtura. Kësisoj, në largimin nga publiku të këtyre komisioneve dhe informacioneve që trajtohen gjatë mbledhjeve, ka kontribuar aktivisht Kuvendi.

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME



Në një formë të përmbledhur, Kuvendi, ka zhvilluar një sesion përveçse të përbërë nga mangësitë e zakonshme, ai ka shfaqur trend të uljes së aktivitetit. Ndonëse rënia ishte një trend i parashikueshëm, numrat ekzistues ishin të papritur dhe pasqyrojnë një sesion gjatë të cilit deputetët kanë ushtruar në formë jo të kënaqshme, funksionet kushtetuese.

Përshkrimi i mangësive të shfaqura gjatë sesionit, është një përsëritje e ngecjeve të zakonshme, meqenëqë në përmbajtje ato ishin tipike për Kuvendin e Kosovës. Kësisoj, legjislatura e tetë, gjatë sesionit të fundit pranveror të mandatit të saj, vazhdoi ngjashëm të organizojë punë në agjenda të ngjeshura e jo mirë të planifikuara; kurse kuorumi mbeti faktori kyç në dështimin e seancave, ndërsa deputetët dëshmuar papërgjegjshmëri edhe me rritjen e numrit të mungesave. Po ashtu, në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, Kuvendi dhe trupat e tij kanë dështuar të performojnë si duhet. Ndërsa, në transparencë ka një hap drejt përmirësimit me rikthimin e pajisjeve elektronike, porse hapa për të zbatuar në praktikë këtë lëvizje mbesin për tu bërë. Në fund, në respektimin e Rregullores dhe në sjelljen e deputetëve, nuk është vërejtur ndonjë përmirësim; gjuha jo-parlamentare dhe sjellja e papërshtatshme vazhdojnë të jenë të pranishme në punimet e Kuvendit të Kosovës.

Praktika dominuese e agjendave të ngarkuara kundrejt seancave të pakta, ka vazhduar të ndiqet si qasje në administrimin e punës parlamentare. Edhe ky sesion, ka prodhuar vazhdime të seancave, proporcionalisht në masë të njëjtë me sesionet e kaluara. Kuvendi duhet të aplikojë një qasje më të kujdesshme në planifikimin e agjendës, që nënvizon rëndësinë e trajtimit të përpiktë të materialit legjislativ, duke hartuar agjenda të trajtueshme për nga arritshmëria dhe ti shtrijë ato në seanca më të shpeshta përgjatë kalendarit të punës.

Mungesa e kuoromit ka vazhduar të jetë problem determinues në organizimin e punës parlamentare. Deputetët, ndonëse edhe në vitet e kaluar kishin treguar numër të lartë të mungesave, shënuan rritje në treguesin e mungesave, i cili është ngritur në 24,3% këtë sesion, nga 22,5% gjatë sesionit pranveror 2023. Kuvendi dhe partitë parlamentare, duhet të shohin mundësitë e administrimit më të saktë të evidencës për deputetët që nuk marrin pjesë në seanca plenare deri në përfundimin e tyre. Mund të konsiderohet si alternativë, edhe kushtëzimi i pjesëmarrjes deri në përfundim të seancës, me kompensimin financiar për seancë.



Lëvizje përkeqësimi [qartazi] janë vërejtur edhe në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës, përmes secilit instrument mbikëqyrjeje. As kreu i ekzekutivit dhe as asnjë ministër/e nuk ka raportuar në seancë të Kuvendit, derisa raportimet e tyre në komisione, shpeshherë shndërroheshin në monologje të pasfiduara të përfaqësuesve të ekzekutivit. Pyetjet parlamentare janë injoruar edhe nga ekzekutivi edhe nga deputetët. Praktika si këto, do të duhej të paraqisnin një model për tu refuzuar, derisa një pjesë e përgjegjësive për aplikimet e tyre në Kuvendin e Kosovës, bie mbi opozitën që refuzoi të përdorte këto mjete kontrolli. Ndonëse të krijuara në mbikëqyrjeje të veprimtarisë së ekzekutivit, komisionet hetimore gjatë këtij sesioni dështuan në hetimin e subjektit për të cilin janë themeluar. **Të gjithë deputetët pa dallim, veçanërisht ata opozitarë, do të duhej të përdornin në mënyrë precize dhe në baza të rregullta këto mjete kontrolli, kurse në temën e komisioneve hetimore parlamentare, në mënyrë që të përmirësohet situata duhet të fillojë procesi për ndryshimin e Ligjit për Hetim Parlamentar, meqë në këto kushte, një pjesë e vështirësive për hetim burojnë nga përmbajtja e mangët e tij.**

Megjithëse me dilema për disa raste kur deputetët votuan gjatë sesionit pranveror, në pikëpamje të transparencës, pajisja e sallës plenare me aparaturat e reja shënon një hap të rëndësishëm drejt rikthimit të transparencës parlamentare. Në publikimin e punës së komisioneve nuk ka përmirësim në transparencë, kurse tërësisht e pa publikuar mbetet puna e komisioneve hetimore. **Kuvendi duhet të veprojë në drejtim të rritjes së transparencës së punës së komisioneve, veçmas të atyre hetimore, duke hapur një portofolio të ndarë për punën e komisioneve hetimore, ku publikohen të dhënat dhe dokumentet e punës së tyre.**



Raporti i punës parlamentare me Rregulloren e Kuvendit, vazhdon të jetë çështje kundërtënëse. Kryetari Konjufca, edhe këtë sesion ka vazhduar që në rastet të caktuara, administrimin e seancave dhe trajtimin e kërkesave apo problemeve ta bëjë kryesisht duke u mbështetur në vullnetin e tij të lirë. Gjatë sesionit, në disa raste janë ndërmarrë veprime krejtësisht në kundërshtim me përcaktimet e Rregullores, derisa kjo praktikë vazhdon të mbetet e pa kritikuar. **Udhëheqësi i këtij institucioni, si autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e interpretimit të Rregullores, duhet të jetë më i kujdesshëm, duke e kufizuar praktikën parlamentare vetëm në përkufizimet e Rregullores.**

Për fund, sjellja e papërshtatshme dhe gjuha jo parlamentare ka vazhduar të jetë e pranishme, megjithëse për shkakun e pasivitetit të Kuvendit në kuptim të organizimit të seancave, ajo është bartur në punën e komisioneve. **Kuvendi duhet të synojë përmirësimin e sjelljes dhe gjuhës së deputetëve. Kësisoj, përveç miratimit të Kodit të Sjelljes, duhet një kujdes i shtuar për aplikim më të përpiktë të dokumenteve që rregullojnë sjelljen e deputetëve, me theks të veçantë seksionin e masave ndëshkimore.**

Duke marrë për bazë zhvillimet gjatë këtij sesioni, KDI ofron rekomandimet e mëposhtme për tu adresuar gjatë sesionit vjeshtor. Këto rekomandime synojnë përmirësimin e efikasitetit, fuqizimin e rolit mbikëqyrës dhe rritjen e transparencës së Kuvendit.

- 1 Planifikimi i Seancave:** Kuvendi duhet të zhvillojë punën përmes një planifikimi më të mirë duke rritur numrin e seancave dhe duke shmangur javët pa seanca. Gjithashtu, agjenda për secilën seancë duhet të jetë realiste dhe e menaxhueshme, në mënyrë që të gjitha pikat të mund të adresohen.
- 2 Pjesëmarrja e Deputetëve:** Deputetët duhet të jenë më të përgjegjshëm në pjesëmarrjen në seanca dhe të qëndrojnë deri në përfundimin e tyre. Kryetari dhe Kryesia e Kuvendit duhet të zbatojë respektimin më të rreptë të Rregullores së Punës, duke kërkuar llogari nga deputetët të cilët mungojnë pa arsye.
- 3 Roli Aktiv i Kryetarit:** Kryetari i Kuvendit duhet të marrë një rol më proaktiv në menaxhimin e seancave. Kjo përfshin shqiptimin e vërejtjeve për Kryeministrin dhe ministrat kur ata nuk i përgjigjen pyetjeve të deputetëve.

4 Fuqizimi i Mbikëqyrjes Parlamentare: Deputetët duhet të përdorin më mirë mekanizmat e mbikëqyrjes duke rritur numrin e pyetjeve të drejtuara ndaj ekzekutivit. Ata gjithashtu duhet të marrin pjesë në seancat ku adresohen pyetjet e tyre dhe të iniciojnë debate parlamentare, interpelanca dhe raportime të ekzekutivit në seanca dhe mbledhje të komisioneve.

5 Miratimi i Kodit të Sjelljes: Kuvendi duhet të përshpejtojë miratimin e Kodit të Sjelljes për deputetët, duke vendosur standarde të qarta për sjelljen dhe disiplinën e tyre gjatë punës parlamentare. Kjo do të kontribuojë në rritjen e përgjegjësive dhe profesionalizmit të tyre.

6 Rritja e Transparencës: Ndërsa rregullimi i sistemit elektronik është një hap pozitiv, Kuvendi duhet të vazhdojë të rrisë transparencën. Kjo përfshin publikimin e dokumenteve si planet e punës, transkriptet dhe procesverbalet nga komisionet. Po ashtu Kuvendi duhet të bëjë publike përmbledhjet nga puna e komisioneve ad-hoc dhe atyre hetimore.





**SHËNIMET
FUNDORË**



1 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/PlenarySessions>

2 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 7; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

3 Informacionin e gjeni në dokumentin e Evidencës së Ligjeve, i qasshëm në vegëzën: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Documents/Evidencaeligijsje_c4KEdYr9m.pdf

4 Lajmet për mbledhjet në fjalë i gjeni në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzat e mëposhtme: a: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-vazhdoi-punimet-e-dy-seancave-plenare-35212/>; b: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/kuvendi-zhvilloi-punimet-e-seances-plenare-35279/>

5 Rregullorja e Kuvendit, Neni 2, Par. 1.8, f. 2; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

6 Kushtetuta e Kosovës, Neni 65, Paragrafi 9, i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

7 Kushtetura e Kosovës, Neni 65, Par. 9; Neni 70, Par. 1; Neni 74; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

8 Informacionin e gjeni në dokumentin e Evidencës së Ligjeve, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-punimet-e-seances-plenare-33315/>

9 Artikull mediatiq: "Në përpjekjen e tetë formohet komisioni hetimor për rezervat shtetërore, polemika mes pozitës e opozitës", Kallxo.com, i qasshëm në vegëzën: <https://kallxo.com/lajm/ne-perpiekjen-e-tete-formohet-komisioni-hetimor-per-rezervat-shtetere-polemika-mes-pozites-e-opozites/>

10 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/60>

11 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/61>

12 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/63>

13 "Polemika mes deputetëve Shemsedin Dreshaj dhe Armend Muja për komisionin hetimor për tekstet shkollorë", Kallxo.com, i qasshëm në vegëzën: <https://kallxo.com/lajm/polemika-mes-deputeteve-shemsedin-dreshaj-dhe-armend-muja-per-komisionin-hetimor-per-tekstet-shkollor/>

14 Dy komisionet që janë duke pritur për tu themeluar janë: Komisioni Hetimor për Mostrat e Astrit Deharit dhe Komisioni Hetimor për Procesin e Përllogaritjes së Borxheve të Kompanive Ambalazhuese të Ujit.

15 LIGJI PËR HETIM PARLAMENTAR, Neni. 2, Par. 3, f.2; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2683>

16 Të dhënat derivojnë nga dokumentet e publikuara në uebfaqen e Kuvendit të Kosovës. Ato janë të mbledhura kumulativisht nëpërmjet leximit të transkripteve të seancave.

17 KDI: PUNA E KUVENDIT TË KOSOVËS GJATË VITIT 2023, Dhjetor 2023, f. 11; i qasshëm në vegëzën: https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/12/35-Raport-PerformancaeKuvenditeKosoves-ALB-03_mjbTSMVsiz.pdf

18 Lajmi në ueb-faqën e Kuvendit, i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/per-publikun/lajmi/u-miratua-rregullorja-e-re-e-kuvendit-30357/>

19 Rregullorja e Kuvendit, Neni 122, Paragrafi 1, f. 52; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

20 Rregullorja e Kuvendit, Neni 92, Paragrafi 8; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

21 Transkripti i Seancës, Mbledhja 20/04/2023, f.44; i qasshëm në vegëzën: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2023_04_20_ts_Seanca_10.00_eeqKriDquU.pdf?fbclid=IwAR1ibSrztqT2FbrzQvt6YDp163I20dk69iB60JUvXoCmDb8Bq0xix-1j_9kq

22 Transkripti i Seancës, Mbledhja 08/02/2024, f. 32 : i qasshëm në vegëzën: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2024_02_08_ts_Seanca_rPRkT9ujhs.pdf

23 LIGJI PËR HETIM PARLAMENTAR, Neni 6, Paragrafi 3, f. 3, i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2683>

24 Përgjigje nga zyrtarët e Kuvendit në kërkesën e KDI-së, data: 4/3/2023.

25 Rregullorja e Kuvendit, Neni 46, f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

26 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/seanca-plenare-e-kuvendit-35140/>

27 Rregullorja e Kuvendit, Neni 63, Paragrafi 5, f. 28; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

28 "Nuk kalon marrëveshja me Danimarkën për burgje, PDK voton kundër", Kallxo.com, i qasshëm në vegëzën: <https://kallxo.com/lajm/nuk-kalon-marreveshja-me-danimarken-per-burgje-pdk-voton-kunder/>

29 Transkripti i Seancës, Mbledhja 23/04/2024, f.15, në vegëzën: https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2024_05_23_ts_Seanca_h4tYuGUJda.pdf

30 Rregullorja e Kuvendit, Neni 83, Paragrafi.3, f. 36; i qasshëm në vegëzën: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkq1WSEcTI3ZFBSCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgmndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

31 Mungesat janë të mbledhura nga të dhënat për pjesëmarrjen e deputetëve, të cilat KDI i merr nga Kuvendi i Kosovës në baza mujore.

32 Deputetja Ganimete Musliu, gjatë sesionit pranveror 2024, për shkak të problemeve shëndetësore e ka pasur të pamundur të jetë e pranishme në punimet e Kuvendit.

33 "Ofendime dhe përplasje të ashpra, krejt çka ndodhi në Komisionin Hetimor në Kuvend", Portali Telegrafi, i qasshëm në vegëzën, <https://telegafi.com/ofendime-dhe-perplasje-te-ashpra-krejt-cka-ndodhi-ne-komisionin-hetimor-ne-kuvend/>

34 "Komisioni për Legjislacion miratoi Draft-Kodin e sjelljes së deputetëve të Republikës së Kosovës", mbledhja e datës 30.04.2024 i qasshëm në vegëzën: <https://www.assembly-kosova.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/komisioni-per-legjislacion-miratoi-draft-kodi-35103/>

35 DRAFT KODI I SJELLJES [Versioni Fillestar], Neni 28, Par. E, f. 11.

36 KDI: PUNA E KUVENDIT TË KOSOVËS GJATË VITIT 2023, Dhjetor 2023, f. 18-19; i qasshëm në vegëzën: https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/12/35-Raport-PerformancaeKuvenditeKosoves-ALB-03_mjbTSMVsiz.pdf

37 DRAFT KODI I SJELLJES [Versioni Përfundimtar], Neni 26, Par. 1, e, f. 10

38 DRAFT KODI I SJELLJES [Versioni Përfundimtar], Neni 26, Par. 1, d, f. 10



39 Mendim Ligjor për Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media, Maj 2024, f. 14-17, i qasshëm në vegëzën: https://rm.coe.int/legal-opinion-on-the-draft-law-on-the-independent-media-commission-of-/1680afd33b?fbclid=IwY2xjawEUZ6BleHRuA-2FibQlxMAABHeH2g-Fdalq1uBhBjZ-xaUhxSLeOZXHAFbEDqVplGCTz-Jxf1buvFXDYXpa_aem_zJK_kJ2dg8IQ-HrG4H6UuA

40 Mendim Ligjor për Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Media, Maj 2024, f. 1, i qasshëm në vegëzën: https://rm.coe.int/legal-opinion-on-the-draft-law-on-the-independent-media-commission-of-/1680afd33b?fbclid=IwY2xjawEUZ6BleHRuA2FibQlxMAABHeH2g-Fdalq1uBhBjZ-xaUhxSLeOZXHAFbEDqVplGCTz-Jxf1buvFXDYXpa_aem_zJK_kJ2dg8IQ-HrG4H6UuA

41 Publikim i Kryetarit të Komisionit, Valon Ramadani, në llogarinë tij zyrtare në rrjetin shoqëror Facebook, i qasshëm në linkun: https://www.facebook.com/ValonRamadaniVV/posts/1008104547985697?ref=embed_post

42 "PDK do t'i dërgojmë në Kushtetuese ligjin për KPK-në dhe për KPM-në", Kallxo.com, i qasshëm në: <https://kallxo.com/lajm/pdk-do-ti-dergojme-ne-kushtetuese-ligjin-per-kpk-ne-dhe-ate-per-kpm-ne/>

43 "REFORMA NË DREJTËSI: Arritjet, Sfidat, Rruga Përpara", KDI, 2024, f. 13, i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2024/06/20-Raport-Progressi-i-Reformes-s-ne-7-Drejte?si-ALB-04-1.pdf>

44 Komunikatë nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, 15.07.2023, e qasshëm në vegëzën: <https://prokuroria-rks.org/kpk/lajm/kpk-reagon-ndaj-mirimit-te-projektligjit-te-ri-per-kpk-ne-nga-kuvendi-i-kosoves/>

45 "Opozita: Do t'i dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për KPK-në dhe atë për KPM-në", Betimi në Drejtësi, <https://betimiperdrejtesi.com/opozita-do-ti-dergojme-ne-gjykatën-kushtetuese-ligjin-per-kpk-ne-dhe-ate-per-kpm-ne/>

46 Të dhënat janë të qasshme në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions>

47 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

48 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

49 Të dhëna janë të qasshme në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/39>

50 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

51 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhje-e-komisionit-per-buxhet-pune-dhe-tra-34538/>

52 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhje-e-komisionit-per-buxhet-pune-dhe-tra-34655/>

53 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhje-e-komisionit-per-buxhet-pune-dhe-tra-34700/>

54 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-vazhdimi-i-mbledhjes-se-komisionit-per-bu-34478/>

55 Të dhëna janë të qasshme në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/40>

56 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

57 Të dhëna janë të qasshme në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/41>

58 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 17; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

59 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/komisioni-per-legjislacion-miratoi-draft-kodi-35103/>

60 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-legjislacion-35203/>

61 Tryezë Diskutimi, KDI: "Progresi i Reformës në Drejtësi"; 10.06.2024

62 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/42>

63 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 18; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

64 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-integrim-evropian-34989/>

65 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhje-e-komisionit-per-integrim-evropian-35429/>

66 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 18; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

67 Lajmi i qasshëm në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-punete-jashtme-34463/>

68 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 19; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

69 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhja-e-komisionit-per-arsim-shkence-tekno-35179/>

70 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-arsim-shkence-t-34694/>

71 Informacioni në platformën Votalme, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/45>

72 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 19; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

73 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/komisioni-per-ekonomi-industri-ndermarresi-dh-34873/>

74 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënia në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

75 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-shendetesi-dhe-34285/>

76 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-shendetesi-dhe-34363/>

77 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/komisioni-per-shendetesi-dhe-mireqenie-social-34442/>

78 Informacioni në platformën Votalme, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/46>





79 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 19-20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

80 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/48>

81 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

82 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Komisionit të Pavarur të Medieve: https://kpm-ks.org/lajmi_i_plot/3666

83 Dokument i publikuar në llogarinë zyrtare të Kryetarit të Komisionit për Administratë, Valon Ramadani, në vegëzën: <https://www.facebook.com/photo/?fbid=923137129815773&set=a.338634528266039>

84 Deklarim në llogarinë zyrtare të KPM-së, në rrjetin shoqëror Facebook; i qasshëm në vegëzën: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=826617352840395&id=100064764128454

85 Deklarim në llogarinë zyrtare të KPM-së, në rrjetin shoqëror Facebook; i qasshëm në vegëzën: https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=849342097234587&id=100064764128454

86 "RTK-ja publikon raportimin pa fakte të "Slobodna Bosna" se dy medime në Kosovë financohen nga Serbia", Sbukner, i qasshëm në vegëzën: <https://sbunker.org/sr/djinfo/rtk-ja-publikon-raportimin-pa-fakte-te-slobodna-bosna-se-dy-medime-ne-kosove-financohen-nga-serbia/>

87 "Redaktori Musliu distancohet nga lajmi skandaloz i "Slobodna Bosna" – tregon kush i tha se duhet të publikohet", DUKAGJINI, i qasshëm në vegëzën: <https://www.dukagjini.com/redaktori-musliu-distancohet-nga-lajmi-skandaloz-i-slobodna-bosna-tregon-kush-i-tha-se-duhet-te-publikohet/>

88 Shih: <https://telegafi.com/agk-dhe-shoqeria-civile-demon-nderhyrjen-politike-ne-punen-e-kpm-se-deputetet-e-lvv-se-ushtruan-preservation-ndaj-anetareve-te-komisionit/>

89 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-seanca-plenare-e-kuvendit-35532/>

90 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/49>

91 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 20; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

92 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/nga-mbledhja-e-komisionit-per-ceshtje-te-sigu-34255/>

93 Lajmi i qasshëm në ueb-faqën zyrtare të Kuvendit, në vegëzën: <https://www.kuvendikosoves.org/shq/punesimi/per-publikun/lajmi/mbledhje-e-komisionit-per-ceshtje-te-sigurise-34430/>

94 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/50>



95 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

96 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/51>

97 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

98 Po aty.

99 Informacionin e gjeni në Platformën Votaime, në vegëzën: <https://www.votaime.org/Public/Commissions/ViewCommission/52>

100 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit Kombëtar: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 21; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>

101 "Korenica i VV-së ngre dyshimet se "nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për votimin e disa projektligjeve", DUKAGJINI, i qasshëm në vegëzën: <https://www.dukagjini.com/korenica-i-vv-se-ngre-dyshimet-se-nuk-ka-pasur-kuorum-te-mjaftueshem-per-votimin-e-disa-projektligjeve/>

102 Rregullorja e Kuvendit, Neni 117, Par. 6.2, f. 50; <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1WSEc-TI3ZFB5GcbPz0Vh5lt7ysr9nvzgMndq-6nYhvijjBQF00qKQ>

103 Raporti i KDI-së për Sesionin Pranveror të Kuvendit: "Ligjvënja në mes sfidash", f. 23; i qasshëm në vegëzën: <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2023/08/Raporti-Final-Sesioni-Pranveror-i-Kuvendit.pdf>



